



FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr.51

2005

23 qershor

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Ligj nr.9410 datë 20.5.2005	Për ratifikimin e “Marrëveshjes detare ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës të Turqisë.....	1829
Ligj nr.9411 datë 20.5.2005	Për ratifikimin e “Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Rumanisë për zgjidhjen e borxhit të Republikës së Shqipërisë ndaj Rumanisë....	1837
Ligj nr.9412 datë 20.5.2005	Për ratifikimin e “Marrëveshjes së kredisë ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës për Zhvillim të Këshillit të Europës (CEB), për financimin e fazës së parë të qendrës spitalore universitare “Nënë Tereza”, Tiranë”.....	1839
Ligj nr.9413 datë 20.5.2005	Për ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës të Kroacisë për shërbimet ajrore.....	1859

LIGJ
Nr.9410, datë 20.5.2005

**PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES DETARE NDËRMJET
KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS TË TURQISË**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja detare ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës të Turqisë, bërë në Tiranë më 15 shkurt 2005.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekreten nr.4616, datë 6.6.2005 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

**MARRËVESHJE DETARE
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS TË TURQISË**

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës së Turqisë, këtu më poshtë të referuara si “Palët Kontraktuese” ose “Palët”,

duke dëshiruar të zhvillojnë marrëdhëniet dhe të forcojnë bashkëpunimin ndërmjet Palëve Kontraktuese në fushën e transportit detar, me qëllim që të kontribuojnë në zhvillimin e marrëdhënieve tregtare ndërmjet tyre,

duke njohur rëndësinë e sigurisë detare dhe mbrojtjes së mjedisit, në përputhje me Konventat më të rëndësishme ndërkombëtare,

kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1

Termat

Për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje:

1) Termi “anije e Palës Kontraktuese” do të nënkuptojë çdo anije, që është regjistruar në regjistrin e anijeve të Palës Kontraktuese dhe që mban flamurin e saj, në përputhje me legjislacionin dhe rregullat kombëtare të saj.

Ky term nuk do të përfshijë:

- a) anijet e luftës dhe anijet ndihmëse të Forcave Detare Ushtarake;
- b) anijet e peshkimit;
- c) anijet që kryejnë kërkime shkencore, hidrografike dhe oqeanografike;
- d) anijet që kryejnë funksione speciale shtetërore ose administrative;

e) anijet që transportojnë mbeturina të rrezikshme.

2. Termi “anëtar i ekuipazhit” do të nënkuptojë kapitenin ose çdo person të punësuar në bordin e anijes së përfshirë në listën e ekuipazhit dhe që mban dokumentin përkatës të identitetit, detyra dhe shërbimi i të cilit lidhet me drejtimin e anijes.

3. Termi “transport detar ndërkombëtar” do të nënkuptojë çdo transport me anije, me përjashtim të rastit kur anija operon vetëm ndërmjet porteve të vendosura në territorin e një Pale Kontraktuese.

4. Termi “kabotazh” do të nënkuptojë transportin e mallrave dhe të udhëtarëve ndërmjet porteve të njëres nga Palët Kontraktuese. Termi “kabotazh” do të përfshijë çdo transport mallrash, i cili, megjithëse i shoqëruar me një policë ngarkesë dhe pavarësisht nga destinacioni ose origjina, çohen direkt ose indirekt në portet e çdo njëres nga Palët Kontraktuese, me qëllim për t’u transportuar më pas në një port tjetër të së njëjtës Palë Kontraktuese. E njëjta dispozitë do të zbatohet edhe në rastin e udhëtarëve edhe pse ata transportohen me biletë.

Neni 2

Qëllimi i Marrëveshjes

1. Qëllimi i kësaj Marrëveshjeje është vendosja dhe zhvillimi i marrëdhënieve detare ndërmjet Palëve Kontraktuese, me qëllim zgjerimin e sigurisë detare dhe parandalimin e ndotjes detare; duke nxitur bashkëpunimin teknik, arsimor dhe shoqëritë e përbashkëta në të gjitha fushat detare.

2. Kjo Marrëveshje zëvendëson “Marrëveshjen për transportin detar dhe lundrimin ndërmjet Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë dhe Republikës së Turqisë të përfunduar në Tiranë, më 22 prill 1987”. Vlefshmëria e marrëveshjes së sipërcituar do të pushojë me hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.

3. Palët Kontraktuese do ta bazojnë zhvillimin e marrëdhënieve të tyre në fushën detare mbi parimet e konkurrencës së lirë dhe të drejtë.

4. Dispozitat e kësaj Marrëveshjeje:

- a) Nuk do të zbatohen në portet jo të hapura për hyrjen e anijeve të huaja;
- b) Nuk do të prekin rregullat e brendshme lidhur me hyrjen dhe qëndrimin e të huajve;
- c) Nuk do të zbatohen në veprimtaritë e rezervuara nga secila prej Palëve Kontraktuese për anijet me flamurin e tyre kombëtar, ndërmarrjet ose organizatat e tyre, duke përfshirë kabotazhin, peshkimin detar, pilotimin, rimorkimin, shpëtimin dhe asistencën detare.

Neni 3

Autoritetet kompetente

Për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje autoritetet kompetente të Palëve Kontraktuese janë:

- Në Republikën e Shqipërisë është Ministria e Transportit dhe e Telekomunikacionit;
- Në Republikën e Turqisë është nënsekretariati i Kryeministrit për çështjet detare;

Në rastin e çdo ndryshimi lidhur me emrat ose funksionet e autoriteteve kompetente të Palëve Kontraktuese do të bëjnë njoftimet e nevojshme nëpërmjet kanaleve diplomatike.

Neni 4

Masat në lidhje me zbatimin

Palët Kontraktuese bien dakord të autorizojnë autoritetet e tyre kompetente për të marrë masat që vijnë për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, në bashkëpunim me autoritetet e tjera përkatëse të Palës, brenda kufijve të mundësive të tyre pa paragjykuar detyrimet e tyre ndërkombëtare:

- a) Të mbajnë konsultime me qëllim bërjen e rregullimeve të nevojshme në përputhje me legjislacionin e tyre kombëtar për të siguruar zbatimin e plotë të kësaj Marrëveshjeje;
- b) Të nxisin kontaktet dhe shkëmbimin e informacionit ndërmjet industrive të transportit detar të Republikës së Turqisë dhe Republikës së Shqipërisë;

- c) Të bashkëpunojnë në fushën e ndërtimit dhe të riparimit të anijeve dhe të nxisin shoqëri të përbashkëta ndërmjet industrive respektive të Palëve;
- d) Të vendosin bashkëpunim teknik e arsimor, si dhe shkëmbimin e trajnimit e ndërsjellë në fushën detare;
- e) Të lehtësojnë transportin e mallrave tregtare me rrugë detare dhe sigurimin e shërbimeve portuale;
- f) Të vendosin bashkëpunim në forumet ndërkombëtare respektive.

Neni 5

Parimet drejtuese të transportit detar ndërkombëtar

1. Palët Kontraktuese bien dakord të ndjekin parimet e konkurrencës së lirë dhe të drejtë në transportin detar ndërkombëtar, të abstenojnë ndaj masave të cilat mund të rrezikojnë zhvillimin e transportit detar ndërkombëtar dhe të kërkojnë heqjen e çdo kufizimi të njëanshëm përsa i përket transportit detar ndërkombëtar të mallrave dhe udhëtarëve, të cilat i rezervohen pjesërisht ose totalisht anijeve të Palëve Kontraktuese.

2. Dispozitat e kësaj Marrëveshjeje nuk do të prekin të drejtat e anijeve të vendeve të treta për të marrë pjesë në tregtinë detare ndërmjet porteve të Palëve Kontraktuese.

3. Asgjë në këtë Marrëveshje nuk do t'i pengojë Palët Kontraktuese për të marrë masat përkatëse për sigurimin e pjesëmarrjes së lirë të flotave të tyre tregtare në tregtinë ndërkombëtare mbi bazën e konkurrencës tregtare.

Neni 6

Trajtimi i akorduar i anijeve në porte

1. Secila Palë Kontraktuese do t'u japë anijeve të Palës tjetër Kontraktuese, të njëjtin trajtim që u jep anijeve të saj, të cilat janë të angazhuara në transportin ndërkombëtar detar përsa i përket hyrjes së lirë në porte, përcaktimit të kalatave, përdorimit të plotë të pajisjeve të shkarkimit dhe ngarkimit, ngarkimit dhe shkarkimit të ngarkesave, transitimit, imbarkimit dhe zbarkimit të udhëtarëve, pagesave të taksave dhe tarifave të portit që përdoren për shërbimet me qëllim lundrimin.

2. Palët Kontraktuese do të bëjnë përpjekje, brenda kufijve të legjislacionit të tyre dhe rregullave portuale, si dhe të detyrimeve të tyre sipas ligjit ndërkombëtar, të lehtësojnë dhe të përshpejtojnë procedurat e nevojshme në portet e tyre dhe të thjeshtojnë sa më shumë të jetë e mundur formalitetet e tjera portuale të tilla si ato doganore, shëndetësore dhe policore.

3. Anijet e secilës Palë Kontraktuese, kur prekin një port të palës tjetër për shkarkimin e një pjese të ngarkesës së tyre, pasi të kenë përmbushur detyrimet e ligjeve dhe rregullave të këtij vendi, mund të mbajnë në bord një pjesë të ngarkesës së tyre, e cila është e destinuar në një port tjetër si në të njëjtin vend ose në vend tjetër, ose ta transferojnë atë në një anije tjetër pa pagesë të një tarife ekstra, ndryshe nga ato të mbledhura në raste të njëjta, nga Pala tjetër Kontraktuese mbi anijet e saj. Në të njëjtën mënyrë anijet e secilës Palë Kontraktuese mundet të prekin në një ose më shumë porte të palës tjetër për të ngarkuar plotësisht ose pjesërisht ngarkesën e tyre të destinuar për portet e huaja, pa paguar tarifën, përveçse atyre të mbledhura në raste të njëjta nga Pala tjetër Kontraktuese në anijet e saj.

Neni 7

Dokumentet e anijeve

1. Dokumentet që vërtetojnë kombësinë e anijes, si dhe çdo dokument tjetër i anijes, i lëshuar ose njohur nga njëra Palë Kontraktuese për anijet e saj në përputhje me legjislacionin e saj, do të njihen nga Pala tjetër Kontraktuese.

2. Dokumentet në bordin e një anije të një Pale Kontraktuese, në mënyrë të veçantë atyre të kërkuara për sigurinë e lundrimit dhe mjedisit do të njihen nga autoritetet kompetente të Palës tjetër

Kontraktuese, me kusht që këto dokumente të jenë lëshuar në përputhje me konventat ndërkombëtare të rëndësishme, në të cilat të dyja Palët Kontraktuese janë anëtare.

3. Anijet e secilës Palë Kontraktuese, që mbajnë një certifikatë ndërkombëtare tonazhi të lëshuar në përputhje me Konventën ndërkombëtare mbi përmasat e tonazhit nuk do të jenë objekt i rimatjes së tonazhit në portet e Palës tjetër Kontraktuese.

Certifikata e tonazhit për anijet nën 24 metra e lëshuar në përputhje me ligjin kombëtar do të njihet në mënyrë të ndërsjellë.

Për cisternat e karburantit miqësor—ndaj mjedisit me depozita prej ballasti segregat (SBT), tarifat e portit dhe të pilotimit do të reduktohen:

a) Duke zbritur kapacitetin e hapësirës së SBT-së nga tonazhi bruto i anijes, në përputhje me rezolutën e IMO-së [A747 (18)] ose;

b) Duke bërë një zbritje në proporcion me përqindjen që kapaciteti i hapësirës së SBT-së zë ndaj tonazhit bruto të anijes.

4. Pa marrë parasysh shitjen e detyruar që rezulton pas një vendimi gjyqësor, anijet e secilës nga të dyja Palët Kontraktuese nuk mund të regjistrohen në regjistrin e palës tjetër pa paraqitjen e një certifikate, të lëshuar nga autoritetet kompetente të vendit nga anija ka origjinën, që deklaron se anija është çregjistruar nga regjistri i kësaj pale.

Neni 8

Dokumentet e identitetit të marinarëve

1. Secila nga Palët Kontraktuese do t'i njohë dokumentet e identitetit të marinarëve dhe anëtarëve të ekuipazhit, të cilët janë qytetarë të Palës tjetër Kontraktuese, të lëshuara sipas ligjit nga autoritetet kompetente të kësaj pale, duke i garantuar mbajtësve të tyre të drejtat e referuara në nenet 9, 10 të kësaj Marrëveshjeje, me kushtet e përcaktuara. Këto dokumente janë:

- Në rastin e Republikës së Shqipërisë “Seaman’s passport” Pasaporta e detarit;
- Në rastin e Republikës së Turqisë “Seaman’s Book — Geniadami cuzdani”.

2. Dispozitat e neneve 9 dhe 10 të kësaj Konvente do të zbatohen, sa më shumë të jetë e mundur, edhe ndaj anëtarëve të ekuipazhit të anijeve të Palëve Kontraktuese, të cilët nuk janë qytetarë të Republikës së Turqisë ose të Republikës së Shqipërisë, por zotërojnë një dokument identiteti në përputhje me dispozitat e konventave ndërkombëtare të rëndësishme.

Neni 9

Të drejtat dhe detyrimet në portin e prekjes

1. Anëtarët e ekuipazhit të anijeve të një Pale Kontraktuese që mbajnë dokumente të identitetit të detarit të specifikuar në nenin 8 të kësaj Marrëveshjeje, janë të lejuar të qëndrojnë përkohësisht në breg, pa vizë gjatë qëndrimit të anijeve në portet e Palës tjetër Kontraktuese, me kusht që emrat e tyre të përfshihen në listën e ekuipazhit të paraqitur autoriteteve të portit nga kapitenët në përputhje me rregullat në fuqi në këtë port.

2. Anëtarët e ekuipazhit do të jenë objekt i kontrolleve të rregullta kufitare dhe doganore kur dalin në breg dhe kthehen në anije.

Neni 10

Të drejtat e transitit për anëtarët e ekuipazhit

1. Mbajtësit e dokumentit të identitetit të specifikuar në nenin 8 lejohen të hyjnë në territorin e Palës tjetër Kontraktuese si udhëtarë ose të dalin prej këtij territori për të shkuar në çdo vend tjetër ku hyrja i është garantuar, me çdo mjet transporti, me qëllim bashkimin me anijen e tyre ose transferimit në një anije tjetër, transitimin për t'u bashkuar me anijen e tyre në një vend tjetër, ose për riatdhesim, në rast emergjence ose për çdo qëllim tjetër të miratuar nga autoritetet e këtyre Palëve Kontraktuese.

2. Në secilin nga rastet e specifikuar në këtë nen, anëtarët e ekuipazhit duhet të kenë vizat e

nevojshme të Palës tjetër Kontraktuese, të cilat do të jepen nga autoritetet kompetente brenda një kohe sa më të shkurtër. Këta marinarë duhet të kenë mjetet e nevojshme financiare për të mbuluar shpenzimet e udhëtimit.

3. Nëse anëtarët e ekuipazhit që mbajnë një dokument identifikimi të specifikuar në nenin 8 zbarkojnë në një port të Palës tjetër Kontraktuese për qëllime shëndetësore, ose për ndonjë arsye tjetër të njohura si të vlefshme nga autoritetet përkatëse të kësaj pale, atëherë kjo e fundit do të japë autorizimin e nevojshëm për personin në fjalë për të qëndruar në territorin e saj në rast shtrimi në spital, kthimi në vendin e tij të origjinës ose vazhdimi drejt një porti tjetër imbarkimi me çdo mjet transporti.

Neni 11

Përfshirje nga të drejtat e anëtarëve të ekuipazhit

1. Pa paragjykuar dispozitat e neneve 8 dhe 9 të kësaj Marrëveshjeje, rregullat kombëtare të Palëve Kontraktuese për sa i përket hyrjes, qëndrimit dhe largimit të të huajve do të jenë në fuqi në territoret e Palëve Kontraktuese.

2. Secila Palë Kontraktuese rezervon të drejtën për t'i ndaluar hyrjen dhe/ose qëndrimin në territorin e saj çdo personi që e konsideron të padëshiruar edhe pse ai/ajo, zotëron dokumente identiteti detari të specifikuar në nenin 8.

3. Dispozitat e neneve 8 dhe 9 të kësaj Marrëveshjeje zbatohen gjithashtu ndaj personave në bordin e anijeve të Palëve Kontraktuese, të cilët nuk janë anëtarë të ekuipazhit apo të përfshirë në listën e ekuipazhit, por janë të angazhuar me detyra për sa i përket shërbimeve ose punës në anije gjatë udhëtimit të saj dhe të përfshirë në një listë të veçantë.

Neni 12

Procedimi penal i një anëtari të ekuipazhit

1. Për çdo krim ose faj të shkaktuar në bordin e anijes së një Pale Kontraktuese, ndërsa anija ndodhet brenda ujërave territoriale të Palës tjetër Kontraktuese, autoritetet përkatëse të kësaj Pale Kontraktuese nuk do të fillojnë një procedim penal, pa miratimin e nëpunësve kompetent diplomatikë ose konsullor të shtetit flamurin e të cilit mban anija, me përjashtim të rasteve kur:

- a) Kapiteni i anijes kërkon që të procedohet fajtori;
- b) Pasojat e krimit ose të kundërvajtjes shtrihen në territorin e kësaj Pale Kontraktuese;
- c) Krimi ose kundërvajtja penale dëmtojnë paqen ose rendin publik të kësaj Pale Kontraktuese;
- d) Fillimi i një procedimi penal është i nevojshëm për shtypjen e trafikut të paligjshëm të drogave narkotike ose substancave psikotropike;
- e) Krimi ose kundërvajtja penale është kryer kundër një personi tjetër që nuk është anëtar i ekuipazhit të kësaj anije.

2. Dispozitat e paragrafit 1 të këtij neni nuk do të prekin të drejtën e autoriteteve përkatëse të Palëve Kontraktuese për të ushtruar inspekte ose hetime, lidhur me zbatimin e ligjeve dhe rregullave.

3. Brenda kufijve të legjislacioneve kombëtare përkatëse secila Palë Kontraktuese do të marrë të gjitha masat e duhura, sa më shumë të jetë e mundur, për të shmangur bllokimin e anijeve të Palës tjetër Kontraktuese gjatë ushtrimit të juridiksionit penal, civil dhe disiplinor. Nëse bllokimi konsiderohet i nevojshëm, secila Palë Kontraktuese do të përpiqet që të kufizojë kohën e bllokimit ose do të lejojë anijen të niset me kushtin e lëshimit të një garancie me shkrim nga Pala tjetër Kontraktuese.

Neni 13

Procesi civil

Autoritetet gjyqësore dhe/ose administrative të secilës Palë Kontraktuese nuk do të ndërmarrin ndonjë ndjekje civile brenda anëtarëve të ekuipazhit ose lidhur me një kontratë punësimi të një anëtari ekuipazhi të një anijeje të Palës tjetër Kontraktuese, përveçse kur kërkohet kështu nga nëpunësit diplomatikë ose konsullorë të shtetit, flamurin e të cilit mban anija.

Neni 14

Anijet në rrezik

1. Nëse një anije e Palës Kontraktuese bie në cekinë, thyhet ose pëson një aksident, ose ndonjë rrezik tjetër emergjent brenda ujërave territoriale të Palës tjetër Kontraktuese,

a) Anijes, ekuipazhit dhe udhëtarëve të saj do t'u garantohej, në çdo kohë, i njëjti trajtim, i cili u akordohet anijeve të tyre kombëtare;

b) Ngarkesa dhe artikujt e shkarkuara ose të ruajtura nga anija të specifikuar në këtë nen, nuk do të jenë objekt i taksave doganore, me kushtin që ato nuk do të jenë për përdorim ose konsum në territorin e Palës tjetër Kontraktuese;

c) Anija e rënë në cekinë ose shkëmb, si dhe të gjitha pjesët dhe pajisjet, furnizimet dhe mallrat e shpëtuar, nga anije të tilla ose anije në rrezik, duke përfshirë dhe ato në kalatë ose përfitimet e nxjerra nëse anija shitet, si dhe të gjitha dokumentet e gjetura në bordin e anijes në cekinë ose në shkëmb që i përkasin asaj, do t'i jepen pronarit ose përfaqësuesit të tij kur kjo të pretendohet prej tyre.

2. Dispozitat e këtij neni nuk prekin të drejtat e një prej Palëve Kontraktuese ose atyre të autorizuar nga kjo Palë, për të kërkuar nga Pala tjetër, ose nga ato të autorizuar nga kjo palë e dytë, kompensimin korrespondues për çdo veprim të ndërmarrë për shpëtimin e anijes ose për çdo asistencë të dhënë ndaj anijes dhe ngarkesës.

Neni 15

Transferimi i fitimeve dhe të ardhurave të tjera të kompanive të transportit detar

1. Secila Palë Kontraktuese do t'u garantojë kompanive të transportit detar të Palës tjetër Kontraktuese të drejtën e përdorimit të fitimeve dhe të ardhurave, të fituara nga veprimtaria e transportit detar në territorin e kësaj Pale Kontraktuese për kryerjen e pagesave të ndryshme.

2. Secila nga Palët Kontraktuese do t'u garantojë të njëjtave kompani të drejtën e transferimit të të ardhurave të tilla pas zbritjes të të gjitha pagesave të përmendura më sipër në territorin e Palës Kontraktuese, sipas ligjeve dhe rregullave të kësaj pale.

3. Secila nga Palët Kontraktuese do të lehtësojë transferime të tilla.

Neni 16

Mbrojtja e mjedisit detar

1. Anijet e secilës Palë Kontraktuese do të marrin masat e duhura për parandalimin e dëmeve në mjedis brenda territorit të Palës tjetër Kontraktuese.

2. Anijet e secilës Palë Kontraktuese, në territorin e Palës tjetër Kontraktuese, do të jenë përgjegjëse, për zbatimin e legjislacionit në fuqi në fushën e mbrojtjes së mjedisit të Palës së fundit Kontraktuese.

3. Në rastin e një ndotje detare të shkaktuar nga një anije e një Pale Kontraktuese në territorin e Palës tjetër Kontraktuese, anija ndotëse do të jetë përgjegjëse, sipas legjislacionit të kësaj Pale Kontraktuese dhe konventave përkatëse ndërkombëtare.

Neni 17

Detyrimet në bazë të marrëveshjeve të tjera ndërkombëtare

Dispozitat e kësaj Marrëveshjeje nuk prekin të drejtat dhe detyrimet e Palëve Kontraktuese, që rrjedhin nga konventat dhe marrëveshjet ndërkombëtare në të cilat ato janë palë.

Neni 18

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

1. Çdo divergjencë që mund të dalë nga zbatimi ose interpretimi i dispozitave të kësaj Marrëveshjeje do të zgjidhet ndërmjet autoriteteve kompetente të Palëve Kontraktuese.

2. Nëse divergjencat vazhdojnë me kërkesën e njëres nga Palët Kontraktuese, mund të organizohet një takim me qëllim diskutimin e çështjeve problematike. Data dhe objekti i një mbledhjeje të tillë do të përcaktohet sipas rastit.

3. Nëse një marrëveshje ndërmjet Shqipërisë dhe Bashkimit Europian ose rregullore e Bashkimit Europian e nxjerrë më vonë se hyrja në fuqi e kësaj Marrëveshjeje ndryshon detyrimet dhe zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, të dyja Palët Kontraktuese do të bëjnë konsultime dypalëshe për të rishikuar çështjet në një kohë sa më të shkurtër të mundshme.

Neni 19

Dispozitat përfundimtare

1. Palët Kontraktuese do të njoftojnë menjëherë njëra-tjetrën për përfundimin e procedurave të tyre respektive të ratifikimit të kësaj Marrëveshjeje nëpërmjet kanaleve diplomatike. Marrëveshja do të hyjë në fuqi tridhjetë ditë pas marrjes së njoftimit të fundit.

2. Kjo Marrëveshje do të jetë e vlefshme për një periudhë të pacaktuar kohe pas hyrjes në fuqi.

3. Secila Palë Kontraktuese do të ketë të drejtën e denoncimit të kësaj Marrëveshjeje përmes një njoftimi me shkrim. Denoncimi i kësaj Marrëveshjeje do të hyjë në fuqi dymbëdhjetë muaj pas marrjes së një njoftimi të tillë nga Pala tjetër Kontraktuese.

Nënshkruesit të autorizuar sipas ligjit kanë firmosur këtë Marrëveshje.

Bërë në Tiranë, më 15 shkurt 2005.

Teksti u përgatit në dy kopje dhe në tri gjuhë shqip, turqisht dhe anglisht, të tre tekstet autentikisht të barabartë. Në rast mosmarrëveshjeje, teksti në gjuhën angleze do të ketë përparësi.

Për Këshillin e Ministrave të Republikës së Shqipërisë

Për Qeverinë e Republikës së Turqinë

Spartak Poçi

Ministër i Transportit dhe i Telekomunikacionit

Binali Yıldırım

Ministër i Transportit dhe i
Telekomunikacionit

LIGJ

Nr.9411, datë 20.5.2005

**PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË RUMANISË PËR ZGJIDHJEN E
BORXHIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NDAJ RUMANISË**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Rumanisë për zgjidhjen e borxhit të Republikës së Shqipërisë ndaj Rumanisë.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.4617, datë 6.6.2005 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

MARRËVESHJE

**NDËRMJET QEVERISË SË RUMANISË DHE KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË MBI ZGJIDHJEN E BORXHIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NDAJ
RUMANISË**

Qeveria e Rumanisë e përfaqësuar nga Ministria e Financave Publike dhe Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë i përfaqësuar nga Ministria e Financave (Palët), duke dashur të zhvillojnë marrëdhëniet ekonomike ndërmjet dy vendeve, kanë rënë dakord të zgjidhin borxhin e Republikës së Shqipërisë kundrejt Rumanisë, i cili rrjedh nga llogaritë klering, si më poshtë:

Neni 1

Palët kanë rënë dakord që borxhi i Republikës së Shqipërisë kundrejt Rumanisë, sipas gjendjes më 30.6.2004, është si më poshtë:

- a) Borxhi në rubla të transferueshme është 15 016 966. 01;
- b) Borxhi në USD klering është 300 421.44.

Kurset e këmbimit për këmbimin e rublave të transferueshme dhe të dollarëve klering në dollarë të konvertueshëm, është:

- 2.94 rubla të transferueshme = 1 USD.
- 1 USD klering = 1 USD.

Duke përdorur këto kurse, shuma e borxhit të Republikës së Shqipërisë kundrejt Rumanisë është 5 408 233.0 USD nga e cila;

- 5 107 811.57 USD rrjedh nga llogaritë në rubla të transferueshme;
- 300 421.44 rrjedh nga llogaritë USD klering.

Neni 2

Për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, Qeveria rumune autorizon Bankën Tregtare Rumune (Banka).

Banka do të transferojë shumën që duhet paguar në USD në një llogari likuiduese (më poshtë quajtur “llogaria”).

Neni 3

Shlyerja e totalit të borxhit në USD, siç është theksuar në nenin 1 të kësaj Marrëveshjeje, do të bëhet në USD lirisht të këmbyeshëm, me 20 këste të barabarta gjashtëmujore për një periudhë prej 10

vjetësh duke filluar nga data 20 korrik 2005.

Neni 4

Pagesat e interesat do të kryhen më 20 janar dhe 20 korrik të çdo viti, duke filluar nga korriku i vitit 2005. Mbi shumën e borxhit do të aplikohet interesi *Libor* për një periudhë 6-mujore.

“Libor” është norma e interesit për veprimet në USD në tregun ndërbankar në Londër, siç përcaktohet nga Reuter për shumat dhe periudhat përkatëse, afërsisht në orën 11.00 me orën e Londrës, dy ditë-pune përpara fillimit të periudhës përkatëse të interesit e rumbullakosur me 1/16.

Banka Tregtare Rumune do të njoftojë Ministrinë e Financave për normën faktike të interesit dhe për udhëzimet e pagesës dhe do të konfirmojë, gjithashtu shumat e paguara të interesit të paktën një muaj përpara datës së pagesës.

Llogaritja e interesit do të fillojë në datën e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 5

Banka Tregtare Rumune do të njoftojë Ministrinë e Financave të të dy vendeve mbi gjendjen që është bilanci i “llogarisë” më 31 dhjetor të çdo viti, jo më vonë se 31 marsi i vitit pasardhës.

Neni 6

Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin nga zbatimi ose interpretimi i kësaj Marrëveshjeje, do të zgjidhen në mënyrë miqësore ndërmjet Palëve.

Neni 7

Kjo Marrëveshje mund të ndryshohet me marrëveshje me shkrim ndërmjet “Palëve”.

Neni 8

1. Të dyja Palët do të njoftojnë njëra-tjetrën me shkrim, në rrugë diplomatike, për përmbushjen e procedurave të brendshme ligjore për hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje. Marrëveshja do të hyjë në fuqi në datën e fundit të këtyre njoftimeve.

2. Për qëllimet e zbatimit të kësaj Marrëveshjeje, Palët do të komunikojnë me njëra-tjetrën në adresat e mëposhtme:

Për Ministrinë e Financave të Shqipërisë
Në vëmendje të: Drejtorisë së Borxhit, Ministria e
Financave
Bulevardi “Dëshmorët e Kombit” nr.1
Tiranë, Shqipëri
Tel: ++355 4 22 84 05
Fax: ++355 4 22 84 94

Për Ministrinë e Financave të Rumanisë
Në vëmendje të: Departamentit të Financave të
Jashtme Publike
Ministria e Financave Publike
17, Apolodor Street, Bucharest 050741
Romania
Tel: ++(4021) 410 34 00
Fax: ++(4021) 312 67 92

Për Bankën Tregtare Rumune
Në vëmendje të: Departamentit të Kredisë Dokumentare dhe Financimit të Tregtisë
Banka Tregtare Rumune
5, Regina Elisabeta BLVD.
Bucharest, Romania

Tel: ++(4021) 312 41 04/55 99

Fax: ++(4021) 312 41 04/55 81

3. Kjo Marrëveshje do të mbetet në fuqi deri në përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin prej saj.
Nënshkruar në Bukuresht, më _____ 2004, e hartuar në dy kopje në gjuhën angleze.

LIGJ

Nr.9412, datë 20.5.2005

PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES SË KREDISË NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BANKËS PËR ZHVILLIM TË KËSHILLIT TË EUROPËS (CEB), PËR FINANCIMIN E FAZËS SË PARË TË QENDRËS SPITALORE UNIVERSITARE “NËNË TEREZA”, TIRANË”

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e
Këshillit të Ministrave,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja e kredisë ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së
Shqipërisë dhe Bankës për Zhvillim të Këshillit të Europës (CEB), për financimin e fazës së parë të
Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, Tiranë”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.4618, datë 6.6.2005 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred
Moisiu**

MARRËVESHJE KUADËR KREDIE

**NDËRMJET BANKËS PËR ZHVILLIM TË KËSHILLIT TË EUROPËS DHE KËSHILLIT TË
MINISTRAVE QË PËRFAQËSON REPUBLIKËN E SHQIPËRISË PËR FAZËN E PARË TË
PROJEKTIT TË QENDRËS SPITALORE UNIVERSITARE “NËNË TEREZA”, TIRANË**
F/P 1515 (2005)

Banka për Zhvillim të Këshillit të Europës, organizatë ndërkombëtare, Paris (këtej e tutje e
quajtur CEB), nga njëra anë,

dhe

Këshilli i Ministrave që përfaqëson Republikën e Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e
Financave (këtej e tutje e quajtur Huamarrësi),

duke pasur parasysh kërkesën e dorëzuar nga Këshilli i Ministrave që përfaqëson Republikën
e Shqipërisë, si vend anëtar i CEB-it më datë 24 janar 2005;

duke pasur parasysh rezolutën e Këshillit Administrativ të CEB-it: 1480 (2004);

duke pasur parasysh protokollin e tretë të marrëveshjes së përgjithshme mbi privilegjet dhe

imunitetet e Këshillit të Europës;
duke pasur parasysh nenet e rregulloreve të kredive të CEB-it të muajit nëntor 1999,
ranë dakort për sa vijon:

Neni 1

Kushtet e përgjithshme

Kjo kredi jepet në bazë të kushteve të përgjithshme të rregullave në fuqi të CEB-it për kreditë dhe në bazë të kushteve të veçanta të caktuara nga kjo Kuadër Marrëveshje kredie (këtej e tutje e quajtur Marrëveshja), shtojcave dhe Letrave të saj të Njëanshme (këtej e tutje të quajtura Letra të Njëanshme).

Neni 2

Projekti

CEB-i i akordon Huamarrësit, i cili pranon, një kredi për financimin e pjesshëm të F/P 1515 (2005) të miratuar nga Këshilli Administrativ i CEB-it më 16-17 mars 2005, dhe që ka si qëllim ndërtimin e një godine të re spitalore dhe rinovimin e tre godinave ekzistuese të përfshira në fazën e parë të programit të reformimit të Qendrës Spitalore Universitare të Tiranës.

Kjo kredi jepet nga CEB-i duke marrë parasysh se Huamarrësi do ta përdorë vetëm për financimin e projektit të përshkruar në shtojcën 1 (këtej e tutje të quajtur Projekti), dhe për realizimin e këtij projekti sipas kushteve të cilat jepen në mënyrë të detajuar në shtojcën e sipërpërmendur.

Çdo ndryshim në mënyrën se si zbatohet kredia që nuk është miratuar nga CEB-i, mund të çojë në pezullim, anulim ose ripagim të menjëhershëm të kredisë sipas kushteve të nenit 13 të rregullores së kredive.

Neni 3

Kredia

3.1. Kushtet financiare

Shuma e kredisë së dhënë është:

14 000 000 USD (Katërmëdhjetë milion dollarë amerikanë)

Kjo shumë do të disbursohet me këste sipas kushteve të specifikuara në shtojcën 1.

Për secilin këst, shumën, përqindja e interesit, monedha, data e derdhjes, periudha e ripagimit dhe numrat e llogarive të secilës nga palët për kalim fondesh, do të caktohen bashkërisht nga Huamarrësi dhe CEB-i nëpërmjet faksit. Monedha për secilin këst do të jetë dollari amerikan ose ekuivalenti i tij në euro.

Një Letër e Njëanshme e Marrëveshjes, e cila jep në mënyrë të detajuar kushtet për secilin nga këstet do të hartohet në kohën e disbursimit të fondeve sipas formatit të caktuar në shtojcën 2.

Përqindja e interesit për secilin nga këstet e kredisë do të caktohet përmes Llogarisë së Besimit të Përzgjedhur të CEB-it. Ky interes nuk mund të tejkalojë shumën prej 2 585 000 euro të shumës totale të projektit të miratuar nga Këshilli Administrativ i CEB-it. Interesi është llogaritur në bazë të 300 pikëve në vit (3.00%) në bazë të një kredie me afat 10-vjeçar duke përfshirë një periudhë 5-vjeçare falje. Megjithatë, në rast se përqindja e interesit përpara subvencionimit do të ishte nën përqindjen e normës së interesit, interesi do të jetë i barabartë me këtë normë.

3.2. Tarifat e disbursimit dhe të jodisbursimit

Disbursimi i kredisë me disa këste do të realizohet në përputhje me ecurinë e punimeve të projektit.

Disbursimi i parë duhet të bëhet e shumta brenda 18 muajve pas datës së miratimit të projektit.

Disbursimi do të bazohet në deklaratat e Huamarrësit lidhur me shkallën e kompletimit dhe të

parashikimeve për ecurinë e punimeve për vitin në vijim.

Secili nga kështet do të derdhet atëherë kur 90% e kështit të mëparshëm të jetë përdorur.

CEB-i do të vendosë një tarifë jodisbursimi të përvitshëm prej 0.50% (e pagueshme çdo tremujor) e diferencës midis shumave që duhej të ishin disbursuar (sipas kufijve minimalë të dhënë më poshtë) dhe shumave të disbursuara aktualisht. Shumat e kufijve të sipërpërmendur janë si më poshtë vijon:

- i) Nëse disbursimet që vijnë pas 18 muajve nga miratimi i projektit përfaqësojnë më pak se 20% të shumës së miratuar të kredisë;
- ii) Nëse disbursimet që vijnë pas 24 muajve nga miratimi i projektit përfaqësojnë më pak se 30% të shumës së miratuar të kredisë;
- iii) Nëse disbursimet që vijnë pas 36 muajve nga miratimi i projektit përfaqësojnë më pak se 50% të shumës së miratuar të kredisë.

3.3. Mobilizimi

Me qëllim mobilizimin e kësteve të disbursimit të kredisë, Huamarrësi duhet t'i dërgojë CEB-it para çdo disbursimi notën premtuese të bashkëngjitur (shtojca 3) për secilin kësht disbursimi.

Nota premtuese lëshohet dhe paguhet në llojin e monedhës në të cilën është paguar kështi.

3.4. Vendi

Të gjitha shumat, detyrim i Huamarrësit, sipas kësaj kredie janë të pagueshme ndaj CEB-it në dollarë amerikanë dhe në numrin e llogarisë së komunikuar Huamarrësit nga CEB-i në kohën e disbursimit të çdo kështi. Fakte ose njoftime Swift duhet t'i dërgohen CEB-it nga banka e caktuar nga Huamarrësi për të kryer pagesat, me një njoftim të paktën 5 ditë - pune përpara çdo pagese.

3.5. Datat

Parashikimet e nenit 3 i nënshtrohen konventës për ndryshimin e ditëve vijuese të punës.

Konventa mbi ndryshimin e ditëve vijuese të punës do të thotë një marrëveshje në të cilën, nëse një datë e caktuar qëllon të jetë një ditë e cila nuk është një ditë-pune (Përkufizimi i ditës së punës duhet të jepet në Letrën e Njëanshme), kjo datë do të jetë dita e parë që ndjek atë datë dhe që është një ditë-pune, përveçse kur kjo ditë i takon muajit tjetër kalendarik, rast në të cilin kjo datë do të jetë data paraardhëse që është një ditë-pune.

Neni 4

Monitorimi i kredisë dhe i projektit

4.1.1. Periudha

Çdo pjesë e kështit të kredisë duhet të përdoret nga Huamarrësi për financimin e projektit brenda 12 muajve pas disbursimit të tij nga CEB-i.

Pjesa e kredisë së papërdorur ose pashpërndarë brenda kësaj periudhe duhet t'i ripaguhet CEB-it brenda jo më vonë se 30 ditësh.

Huamarrësi, merr përsipër të mbulojë kostot që rezultojnë nga ky ripagim. Kjo kosto do të korrespondojë me atë që do të përballonte CEB-i si rezultat i zëvendësimit të së njëjtës shumë në ditën e ripagimit për jetën e mbetur të kredisë origjinale. Norma e zëvendësimit do të vendoset nga CEB-i mbi bazën e kushteve të tregut në datën e ripagimit dhe për periudhën në fjalë. Kostoja, për pasojë, do të përlllogaritet duke marrë parasysh diferencën mes normës origjinale dhe normës së zëvendësimit.

4.1.2. Zbatimi i projektit

Ministria e Shëndetësisë është Agjencia Zbatuese për këtë projekt. Për koordinimin dhe supervizionin e vazhdueshëm të zbatimit të aktiviteteve të projektit, Ministria e Shëndetësisë do të përdorë Njësinë e Zbatimit të Projekteve (PIU), që funksionon që prej projektit të rehabilitimit të spitalit të Shkodrës (F/P 1385) financiar nga CEB.

Huamarrësi nëpërmjet PIU-ut do të veprojë me kujdesin dhe përkushtimin e duhur dhe do të vërë në përdorim të gjitha mjetet, veçanërisht ato financiare, teknike, sociale dhe drejtuese, si dhe ato që kanë të bëjnë me mbrojtjen e mjedisit, të cilat do të konsiderohen të domosdoshme për zbatimin siç duhet të projektit.

Në rast se kostot e projektit, siç përshkruhen në shtojcën 1 bashkëngjitur, rriten ose rishikohen për çfarëdolloj arsye, Huamarrësi duhet të garantojë se ekzistojnë burime shtesë financiare për

përfundimin e projektit.

Në veçanti, duhet të garantojë se — para se projekti të zbatohet — të gjitha financimet, të drejtat mbi tokën dhe pronën e paluajtshme që janë të domosdoshme për projektin ekzistojnë, si dhe të gjitha materialet dhe impiantet janë të siguruar në mënyrë të përhershme dhe janë të mirëmbajtura.

Huamarrësi nëpërmjet PIU-t merr përsipër kryesisht që:

- Projekti respekton marrëveshjet përkatëse të Këshillit të Europës;
- Projekti i është nënshtruar një vlerësimi mjedisor duke u bazuar në kuadrin ligjor shqiptar;
- financimi i pjeshëm prej CEB-it nuk i tejkalon 53,2 % të kostos së përgjithshme të projektit,

duke përjashtuar detyrimet për interesin dhe ato financiare, siç përkufizohen në shtojcën 1.

4.1.3. Prokurimi

Prokurimet do të kryhen në përputhje me guidat e prokurimit të CEB-it nëntor 2004, Versioni III (këtej e tutje të quajtura “Procedurat e prokurimit”). CEB-i do të lejojë që të gjitha punimet dhe konsulencat të financuara nën këtë projekt të prokurohen sipas dokumenteve standarde të Bankës Botërore, rishikuar në maj 2004.

Në çdo rast përgjegjësia për zbatimin e projektit dhe gjithashtu përgjegjësia për kontraktimin dhe administrimin e kontratave nën këtë projekt, i takon Huamarrësit.

Në çdo rast, Huamarrësi, nëpërmjet PIU-t, përpara kërkesës për disbursimin e parë, duhet t’i dërgojë CEB-it kopjen përfundimtare të kontratës së firmosur. Huamarrësi, nëpërmjet PIU-t, duhet t’i dërgojë gjithashtu CEB-it raportin e vlerësimit të tenderit dhe rekomandimin për fituesin, si dhe çdo zgjerim apo modifikim të kontratës origjinale si dhe arsyet përkatëse.

CEB-i nuk do të japë “no-objection” lidhur me përgatitjet e prokurimeve nga PIU, duke përfshirë përgatitjen e kontratave, procedurat që zbatohen, por do të rezervojë të drejtën për të kryer një kontroll paraprak ose të mëpasshëm të dokumentacionit të prokurimit duke pasur si bazë një model të caktuar.

Huamarrësi nëpërmjet PIU-t duhet të njoftojë menjëherë CEB-in për çdo vonesë ose ndryshim në planin e prokurimit, i cili mund të ndikojë ndjeshëm për zbatimin në kohë dhe të suksesshëm të kontratave të projektit, si dhe duhet të bjerë dakord me CEB-in, lidhur me masat korrigjuese që duhen ndërmarë.

Metodat e prokurimit për punimet dhe konsulencat nën këtë projekt do të përzgjidhen në përputhje me tabelën e dhënë në shtojcën 4.

4.2. Raportet e Huamarrësit

4.2.1. Raportet mbi ecurinë e projektit

PIU duhet t’i dërgojë CEB-it më bazë tremujori dhe sa herë që kërkohet një disbursim i ri fondesh, një raport progresiv në anglisht për sa më poshtë vijon:

- gjendjen e përdorimit të kredisë;
- ecurinë e planit financiar të projektit;
- ecurinë e vetë projektit;
- hollësi mbi menaxhimin e projektit.

Shtojca 5 paraqet modelin i cili jep në mënyrë specifike informacionin minimal që kërkohet nga CEB-i lidhur me raportet progresive. Gjithashtu mund të përdoren modele alternative që përmbajnë të njëjtin informacion.

Një auditim financiar i pavarur për projektin duhet të kryhet në çdo vit, shpenzimet e të cilit do të paguhën nga shuma e kredisë së këtij projekti.

4.2.2. Raporti përfundimtar i projektit

Në përfundimin e tërë projektit, Huamarrësi nëpërmjet PIU-t duhet të paraqesë raportin përfundimtar, i cili duhet të përmbajë një vlerësim të rrjedhëve ekonomike, financiare, shoqërore dhe mjedisore të projektit.

4.3. Dhënia e informacionit ndaj CEB-it

Huamarrësi përmes PIU-t duhet të mbajë llogaritë kontabël lidhur me projektin, të cilat duhet të jenë në përputhje me standardet ndërkombëtare, të cilat duhet në çdo rast të tregojnë gjendjen e

ecurisë së projektit, në të cilat duhet gjithashtu të regjistrohen të gjitha veprimet e kryera dhe të identifikohet gjendja e asetëve dhe shërbimeve të financuara me anë të kredisë në fjalë.

Huamarrësi përmes PIU-t bie dakord të mirëpresë me përparësi çdo mision me qëllim marrje informacioni që do të kryhet nga punonjës të CEB-it ose këshilltarë të jashtëm të kontraktuar nga CEB-i, si dhe të sigurojë bashkëpunimin e duhur për misionin informues të CEB-it, duke bërë të mundur vizita në vendin e realizimit të projektit. Në veçanti, CEB-i mund të kryejë kontroll në llogaritë kontabël të projektit me anë të një ose me tepër këshilltarëve të zgjedhur prej saj me shpenzimet e Huamarrësit në rast të mospërmbushjes nga Huamarrësi të ndonjë prej detyrimeve të tij në bazë të huasë në fjalë.

Huamarrësi përmes PIU-t bie dakord të kthejë përgjigje brenda një kohe të arsyeshme ndaj çdo kërkesë për informacion nga ana e CEB-t dhe ta shoqërojë përgjigjen me çdo dokument që CEB-i do ta konsiderojë të nevojshëm dhe që mund të arsyetohet me zbatimin e përpiktë të Marrëveshjes, veçanërisht përsa i takon monitorimit të projektit dhe përdorimit të kredisë.

Huamarrësi duhet të njoftojë menjëherë CEB-in lidhur me ndonjë ndryshim ligjor ose nënligjor në sektorin ekonomik që ka lidhje me projektin, ndërsa në një kuptim më të përgjithshëm, për çdo ngjarje që mund të ketë ndonjë ndikim në zbatimin e detyrimeve të veta sipas kësaj Marrëveshjeje. Çdo ndryshim ligjor dhe nënligjor në sektorin ekonomik që ka lidhje me projektin, do të përbëjë një ngjarje siç jepet në listën e shtojcës 13-h të kapitullit 3 të rregullave të huasë të CEB-it dhe mund të çojë në pezullim, zgjidhje ose kthim të menjëhershëm të shumës së kredisë.

Neni 5

Shkarkimi i Huamarrësit prej detyrimeve

Kthimi i shumës së kredisë të përcaktuar në notën premtuese e çliron Huamarrësin nga detyrimet e tij të përcaktuara në seksionin 3.1 më sipër.

Pasi shuma e plotë e principalit të kësaj kredie dhe të gjitha interesat dhe shpenzimet shtesë që rrjedhin prej saj, veçanërisht ato shuma të dhëna në nenet 6 dhe 7 më poshtë, janë shlyer siç duhet, atëherë Huamarrësi do të çlirohet plotësisht nga detyrimet e tij ndaj CEB-it, përveç atyre të caktuara në nenin 4 më lart.

Neni 6

Interesi për vonesa

Pavarësisht mjeteve të tjera në dispozicion të CEB-it në bazë të marrëveshjes konkrete dhe rregullave të kredisë apo, nëse Huamarrësi nuk i paguan të gjitha interesat ose ndonjë shumë tjetër për të cilën detyrohet sipas Marrëveshjes, maksimumi deri në datën e fundit të afatit të pagesës të përcaktuar në marrëveshje, atëherë Huamarrësi duhet të paguajë interesat shtesë mbi shumën që duhet të paguajë dhe që nuk e ka shlyer plotësisht sipas kursit njëmuor të Libor në dollarë amerikanë (nëse kjo datë bie ditë e shtunë, e dielë ose një ditë pushimi për bankën, atëherë do të paguhet ditën e parë vijuese të kësaj dite që është ditë-pune) në orën 11 të paradites (ora lokale në Londër), si dhe 2.5% në vit mbi këtë shumë që nga afati i caktuar deri në datën e pagimit.

Kursi njëmuor LIBOR në USD i zbatueshëm duhet të azhurnohet çdo 30 ditë.

Neni 7

Kostot shtesë

Të gjitha detyrimet dhe taksat e çdo lloji, të detyrueshme për t'u paguar dhe ato të paguara, si dhe të gjitha shpenzimet që rrjedhin edhe nga përmbushja, gjatë zbatimit, likuidimit, zgjidhjes ose pezullimit të kësaj Marrëveshjeje në tërësi ose pjesërisht, ose nga garancia a rifinancimi i kredisë së akorduar, së bashku me të gjitha veprimet gjyqësore ose jashtëgjyqësore që kanë si pikënisje këtë kredi, do të merren përballohen nga Huamarrësi.

Sidoqoftë, dispozitat e nenit 25 të kapitullit 4 të rregullores së kredisë të CEB-it do të

zbatohen lidhur me shpenzimet e procedurave të arbitrazhit të përmendura në këtë kapitull 4.

Neni 8

Siguritë

Huamarrësi deklaron se nuk është marrë përsipër asnjë përgjegjësi tjetër ose nuk do të merret në të ardhmen, e cila mund t'i japë një radhë preference një pale të tretë, një të drejtë preferenciale pagese, një kolateral ose garanci të çfarëdo natyre që mund të sigurojë të drejta shtesë ndaj palëve të treta (këtej e tutje të quajtura Siguri).

Nëse një siguri e tillë i është dhënë një pale të tretë, Huamarrësi bie dakord të krijojë ose të japë një siguri identike në favor të CEB-it ose, kur nuk mund ta bëjë këtë, një siguri ekuivalente, dhe të rezervojë formimin e një sigurie të tillë në favor të CEB-it.

Dështimi në përmbushjen e këtyre dispozitave do të përbënte një rast gabimi siç parashikohet në nenin 13 të kapitullit 3 të rregullores së kredisë të CEB-it dhe mund t'i japë shkas pezullimit, anulimit ose ripagimit të menjëhershëm të kredisë.

Neni 9

Përfaqësimet dhe garancitë

Huamarrësi përfaqëson dhe garanton:

- se organet e tij kompetente e kanë autorizuar të hartojnë Marrëveshjen dhe e kanë autorizuar ta nënshkruajnë atë, në përputhje me ligjet, vendimet, rregulloret, nenet e anëtarësimit, si dhe tekstet e tjera të zbatueshme për të;

- se hartimi dhe zbatimi i Marrëveshjes nuk vjen në kundërshtim me ligjet, vendimet, rregulloret, nenet e anëtarësimit dhe tekstet e tjera të zbatueshme për të dhe se të gjitha lejet, licencat dhe autorizimet e nevojshme për zbatimin e Marrëveshjes janë siguruar dhe do të mbeten të vlefshme përgjatë tërë periudhës së kredisë.

Çdo ndryshim lidhur me përfaqësimet dhe garancitë e mësipërme duhet që për të gjithë periudhën e kredisë t'i bëhen të ditura menjëherë CEB-it, si dhe duhet t'i jepen dokumentet shpjeguese përkatëse.

Neni 10

Marrëdhëniet me palët e treta

Huamarrësi nuk mund të ngrejë një çështje që lidhet me qëllimin e përdorimit të kredisë duke e lidhur me raportin e marrëdhënieve që ka me palë të treta, me qëllim mënjanimin e përmbushjes së detyrimeve që rrjedhin nga Marrëveshja në mënyrë të plotë ose të pjesshme.

CEB-i nuk do të përfshihet në mosmarrëveshje që mund të ndodhin ndërmjet Huamarrësit dhe palëve të treta dhe shpenzimet, pavarësisht të çfarë natyre, të marra përsipër nga CEB-i për ndonjë shkak, dhe veçanërisht të gjitha shpenzimet ligjore ose gjyqësore, do të jenë në ngarkim të Huamarrësit.

Neni 11

Interpretimi i Marrëveshjes

Huamarrësi deklaron se ka marrë në konsideratë rregulloren e kredive të CEB-it dhe se ka një kopje të tyre.

Kur ka një mospërputhje ndërmjet parashikimeve të çfarëdoshme të rregullores së kredive të CEB-it dhe parashikimeve të Marrëveshjes, atëherë do të mbizotërojnë parashikimet e Marrëveshjes.

Titujt e paragrafëve, pjesëve dhe kapitujve të Marrëveshjes nuk duhen të shërbejnë për interpretimin e saj.

Në asnjë rast nuk duhet hamendësuar se CEB-i ka hequr dorë në mënyrë të heshtur nga ndonjë

e drejtë që i është dhënë asaj në Marrëveshje.

Neni 12

Ligji i aplikueshëm

Marrëveshja dhe garancitë e negociueshme të saj do t'u nënshtrohen rregullave të CEB-it siç parashikohet shprehimisht në nenin 1 paragrafi 3 të protokollit të tretë, që daton më 6 mars 1959 të marrëveshjes së përgjithshme mbi privilegjet dhe imunitetet të Këshillit të Europës të datës 2 shtator 1949 dhe, së dyti, nëse është e nevojshme legjislacionit francez dhe ai shqiptar.

Mosmarrëveshjet ndërmjet palëve të kësaj Marrëveshjeje do t'i nënshtrohen arbitrazhit në bazë të parashikimeve të dhëna në kapitullin 4 të rregullores së kredive të CEB-it.

Neni 13

Zbatimi i një titulli arbitrazhi

Palët e marrëveshjes bien dakord të mos përfitojnë nga ndonjë privilegj, imunitet ose nga legjislacioni para ndonjë juridiksioni ose autoriteti tjetër, kombëtar ose ndërkombëtar, me qëllim që të kundërshtojnë ekzekutimin e një vendimi të marrë, bazuar në kushtet e përcaktuara në kapitullin 4 të rregullave të kredisë të KBE-së.

Neni 14

Njoftimet

Çdo njoftim apo komunikim tjetër që duhet të jepet ose bëhet sipas kësaj Marrëveshjeje ndaj CEB-it ose Huamarrësit duhet të jetë me shkrim dhe do të konsiderohet si i përmbushur rregullisht kur dërgohet dorazi, me postë ajrore, me faks nga njëra palë te tjetra, në adresat e secilës prej tyre, që jepen në mënyrë të detajuar më poshtë.

Për Huamarrësin:

Ministria e Financave

Tiranë

Republika e Shqipërisë

Nënshkruar nga Ministri i Financave:

Tel: 355 4 250264

Fax: 355 4 228494

Për CEB-in:

Banka për Zhvillim e Këshillit të Europës

55 Avenue (Bulevardi) Kléber

75116 Paris

Nënshkruar nga Guvernatori

Fax: +33.1.47.55.03.38

Të gjitha komunikimet që do të jepen dhe merren do të bëhen në gjuhën angleze.

Neni 15

Hyrja në fuqi

Kjo Marrëveshje kuadër kredie do të hyjë në fuqi 15 ditë pas publikimit në Fletoren Zyrtare të ligjit që do të ratifikojë këtë Marrëveshje kuadër kredie në Parlamentin e Huamarrësi.

Neni 16
Kopje të Marrëveshjes

Marrëveshja hartohet në dy kopje origjinale në gjuhën angleze, secila prej të cilave është njëllor e vlefshme me tjetrën.

Secila nga palët e Marrëveshjes pajiset me një dokument origjinal.

SHTOJCA 1
PËRSHKRIMI I PROJEKTIT

I. F/P:	1515 (2005)
Huamarrësi:	Shqipëria
Miratimi nga Këshilli Administrativ:	16-17 mars 2005 CA/PV/
Shuma e miratuar:	14 000 000 dollarë amerikanë

II. Fushat ku veprohet:	Shëndetësi
Punimet e planifikuara	Projekti do të mundësojë ndërtimin brenda Qendrës Spitalore Universitare të Tiranës (QSUT) të një godine të re që do të ketë departamentin e mjekësisë së sëmundjeve të brendshme, urgjencën, reanimacionin, laboratorin, skanerin, si dhe departamentin administrativ me një kapacitet të përgjithshëm prej 90 shtretërish. Për më tepër, tre godina të vogla ekzistuese do të rindërtohen. Kontributi i CEB-it nuk do të përdoret për të financuar blerjen e pajisjeve, për të cilat ka kontribuar tashmë Banka Botërore.
Vendndodhja:	QSUT ndodhet në pjesën qendrore të verilindjes së Tiranës.
Kosto totale e projektit:	26 300 000 dollarë amerikanë
Kosto e shpërndarë sipas zërave:	Në dollarë amerikanë Punime civile20 250 000 Masterplani900 000 Pajisje4 000 000 Mbikëqyrja e punimeve900 000 Auditimi/kontrolli150 000 Shpenzime administrative (PIU)100 000
Plani financiar:	14 000 000 dollarë amerikanë CEB (53,24%) 7 400 000 dollarë amerikanë Qeveria shqiptare (28,14%) 4 900 000 dollarë amerikanë Banka Botërore/IDA (18,64%)
Ecuria e punimeve në paraqitjen e kërkesës:	18,64%
Afati i punimeve:	2005-2008
Kushtet e veçanta	Disbursimi i parë i fondeve nga ana e CEB-it do të bëhet menjëherë në çastin e mobilizimit të PIU-t. Disbursimet pasuese do të jenë në varësi të transferimeve në kohë të kontributeve korresponduese kombëtare të PIU-t në llogarinë rrjedhëse të çelur nga PIU dhe të njohur e të pranuar në raportet financiare të veprimtarisë çdo tremujor që do të dorëzohet pranë PIU-t nëpërmjet Agjencisë Zbatuese të projektit.

III.Kriteret e përzgjedhjes: (sipas zonës së veprimit)	Projekti përputhet me kriteret e përzgjedhjes të përcaktuara në Rezolutën 1480 (2004).
--	--

IV. Rrjedhojat shoqërore: (sipas zonës së veprimit)	Projekti do të përmirësojë ndjeshëm përkujdesin e ofruar me një cilësi të mirë nga ana e spitalit për popullsinë shqiptare, duke marrë parasysh se
---	--

	50% e 50 000 pacientëve të trajtuar çdo vit në spital vjen nga zona jashtë Tiranës. Godina e re mund të akomodojë rreth 6000 pacientë në vit dhe do të jetë pika qendrore e QSUT– spitali kryesor në Shqipëri. Ai do të vendosë në zbatim kritere të reja të shërbimeve shëndetësore që do të përfshijnë një bashkërendim më të mirë ndërmjet shërbimeve sipas specialiteteve, një metodë që i përshtatet nevojave të pacientëve dhe një fleksibilitet të madh për ndryshime të mundshme. Godina e re do të jetë e dobishme edhe për universitetin dhe do të jetë një qendër e rëndësishme për trajnimin e infermierëve, mjekëve dhe doktorëve me standardet e reja të kujdesit mjekësor. Së fundi, rinovimi i 3 godinave të tjera është një domosdoshmëri për t'u ofruar pacientëve standardë të përshtatshme të përkujdesit mjekësor.
--	---

SHTOJCA 2 A

MODELI I LETRËS SË NJËANSHME PËR NJË KREDI ME INTERES TË LUHATSHËM
F/P 1515 –[numri] kështit

BANKA PËR ZHVILLIM E KËSHILLIT TË EUROPËS LETËR E NJËANSHME

Lidhur me Marrëveshjen e kredisë e datës [data] ndërmjet Bankës për Zhvillim të Këshillit të Europës (këtej e tutje të quajtur “CEB”–“KBE”) dhe Republikës së Shqipërisë (këtej e tutje të quajtur “Huamarrësi”).

Kjo Letër e Njëanshme dhe Marrëveshja kuadër e kredisë përcaktojnë termat dhe kushtet mbi të cilat është rënë dakord për kështet [numri] sipas nenit [numër] të Marrëveshjes kuadër të kredisë të përmendur më lart.

Shuma e kredisë	[monedha dhe shuma]
Afati	[numri]–i vitit të fundit me afat prej [numri] vitesh periudha e faljes [ose (numri) –viti]
Euribor (ose Libor)	[vini përkufizimin e Euribor ose Libor]
Përqindja e interesave të ndryshueshëm	Euribor ose Libor 3 ose 6 muaj plus ose minus [numri] të pikëve bazë [neto] në vit [pas zbritjes së (numrit) pikëve bazë të përqindjes së interesit të subvencionuar nga llogaria përzgjedhëse e besimit] (Telerate [referenca] ose Reuters [referenca])
Pagimi i interesave	Detyrimet tremujore/gjashtëmujore
Ndarja për numërimin e ditëve	faktik/360, Konventa për ndryshimin e ditëve vijuese të punës
Ditë-pune (euro)	Do të thotë një ditë në të cilën funksionon Sistemi Automatik Trans-Europian i Transfertave Ekspres të shumave bruto në Kohë Reale - (Target)
ose(të tjera)	Do të thotë një ditë-pune në vendin e llojit të monedhës
Data e disbursimit	[datë]
Udhëzimet e pagesës (Huamarrësi)	Numri i llogarisë [numri] i [emri i Bankës dhe qyteti]. Kodi Swift: [i koduar] përmes [emri korrespondues i bankës dhe qytetit] Kodi Swift: [i koduar]
Udhëzimet e pagesës (CEB)	Nga neni 3.4 i Marrëveshjes kuadër të kredisë

[shtoni ku nevojitet]

{Teksti për interesin bazë Libor dhe struktura për kthimin e kredisë}

Përqindja e interesit duhet të llogaritet për secilën nga periudhat mujore [numri], duke filluar nga data e disbursimit. Interesi duhet të përcaktohet dy ditë-pune (të Londrës) para secilës prej periudhave të reja vijuese të interesit. CEB-i duhet të njoftojë Huamarrësin lidhur me interesin që

duhet të paguhet çdo [numër] muaj. Pagesa e interesit duhet të kryhet me [dita, muaji]¹ të çdo vit, ndërsa për herë të parë më [data]. [rendisni datat e ripagimit dhe shumën e principalit që duhet shlyer në secilën nga këto data]}

{Teksti për interesin bazë Libor dhe pjesët përbërëse të strukturës së kredisë}

Përqindja e interesit duhet të llogaritet për çdo [numër] periudhë mujore, duke filluar nga data e disbursimit. Interesi duhet të përcaktohet dy ditë-pune (të Londrës) para secilës prej periudhave të interesit. CEB-i duhet të njoftojë Huamarrësin lidhur me interesin që duhet paguar çdo [numër] muaj. Pagesa e interesit duhet të kryhet më [dita, muaji]² të çdo viti, dhe për herën e parë më [data]. Principali duhet të ripaguhet si një shumë në total më [data].}

{Teksti për interesin bazë Euribor dhe struktura për kthimin e kredisë}

Përqindja e interesit duhet të përllogaritet për çdo periudhë [numri] mujore, duke filluar nga data e disbursimit. Interesi duhet të përcaktohet dy ditë-pune para secilës nga periudhat e reja vijuese të interesit. CEB-i duhet të njoftojë Huamarrësin lidhur me interesin për t'u paguar çdo [numri] muaj. Pagesa e interesit duhet të kryhet me [data, muaji]³ të çdo viti, dhe për herë të parë më [data]. [rendisni datat e ripagimit dhe shumën e principalit që duhet shlyer në secilën nga këto data]}

{Teksti për interesin bazë Euribor dhe pjesët përbërëse të strukturës së kredisë}

Përqindja e interesit duhet të përllogaritet për çdo periudhë [numri] mujore, duke filluar nga data e disbursimit. Interesi duhet të përcaktohet dy ditë-pune para secilës nga periudhat e reja vijuese të interesit. CEB-i duhet të njoftojë Huamarrësin lidhur me interesin për t'u paguar çdo [numri] muaj. Pagesa e interesit duhet të kryhet më [data, muaji]⁴ të çdo viti, dhe për herë të parë më [data]. Principali duhet të ripaguhet si një shumë në total më [data].}

Të gjitha pagesat duhet t'i shlyhen KBE-së në numrin e vet të llogarisë në përputhje me Udhëzimet e Pagesës (të CEB-it) të përshkruara më sipër.

Këto parashikime janë në përputhje me marrëveshjen "Konventa për ndryshimin e ditëve vijuese të punës", përkufizimi i së cilës gjendet në nenin 3.5 të Marrëveshjes kuadër të kredisë të nënshkruar ndërmjet CEB-it dhe Huamarrësit më [data].

Me qëllim që të fillojë derdhja e kësaj kredie, Huamarrësi duhet që në afatin e caktuar t'i dërgojë CEB-it një letër pranimi, e cila i korrespondon kësaj derdhjeje [shihni shtojcën 3].

[Qyteti, data]
Për Këshillin e Europës
Banka për Zhvillim

[Qyteti, data]
Për [emri i Huamarrësit]

SHTOJCA 2 B
MODELI I LETRËS SË NJËANSHME PËR NJË KREDI
ME PËRQINDJE INTERESI FIKSE
F/P 1515 – [numri] këstit

BANKA PËR ZHVILLIM E KËSHILLIT TË EUROPËS
LETËR E NJËANSHME

Lidhur me Marrëveshjen kuadër të kredisë të datës [data] ndërmjet Bankës për Zhvillim e Këshillit të Europës (këtej e tutje të quajtur "CEB") dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë (këtej e tutje të quajtur "Huamarrësi").

Kjo Letër e Njëanshme dhe Marrëveshja kuadër e kredisë përcaktojnë termat dhe kushtet mbi të cilat është rënë dakord për [numrin] këste duke iu referuar nenit [numri] të kësaj Marrëveshje kuadër kredie.

¹ Përmendni 4 data për pagesat katër-mujore dhe 2 data për pagesat gjashtë-mujore

² Përmendni 4 data për pagesat katër-mujore dhe 2 data për pagesat gjashtë-mujore

³ Përmendni 4 data për pagesat katërmujore dhe 2 data për pagesat gjashtëmujore

⁴ Përmendni 4 data për pagesat katërmujore dhe 2 data për pagesat gjashtëmujore

Sasia e kredisë	[monedha dhe shuma]
Afati	[numri]–viti i fundit për afatin prej [numri] vitesh periudhe faljeje [ose (numri) - viti]
Përqindja e interesit fiks	[numër përqindje] [neto] në vit
Pagimi i interesave	Detyrimet gjysmëvjetore/vjetore
Ndarja e ditëve	30/360 i pandryshuar, Konventa për ndryshimin e ditëve vijuese të punës
Ditë-pune(euro)	Do të thotë një ditë në të cilën funksionon Sistemi Automatik Trans-European i Transfertave Ekspres të Shumave Bruto në Kohë Reale - (Target)
Ose (të tjera)	Do të thotë një ditë-pune në vendin e llojit të monedhës
Data e disbursimit	[data]
Udhëzimet e pagesës (Huamarrësi)	Llogaria numër [numri] e [emri i Bankës dhe qyteti]. Kodi Swift: [i koduar] përmes [emri i bankës korresponduese dhe qyteti] Kodi Swift: [i koduar]
Udhëzimet e pagesës (CEB)	Nga neni 3.4 i Marrëveshjes kuadër të kredisë

Pagesat e interesit dhe principalit duhet të kryhen në përputhje me programin e bashkëngjitur të shlyerjeve. Nëse interesi do të paguhet për herë të parë në [data], principalin do të ripaguhet për herë të parë në [data].

Të gjitha pagesat duhet të derdhen në llogarinë e KBE-së në zbatim të udhëzimeve të pagesës (të CEB-it) të përshkruara më lart.

Këto parashikime bazohen në marrëveshjen "Konventa për ndryshimin e ditëve vijuese të punës", përkufizimi i së cilës gjendet në nenin 3.5 të Marrëveshjes kuadër të kredisë së nënshkruar ndërmjet CEB-it dhe Huamarrësit në [data].

Me qëllim që të fillojë derdhja e kësaj kredie, Huamarrësi duhet që në afatin e caktuar t'i dërgojë CEB-it një letër pranimit që përputhet me këtë derdhje fondesh [shihni shtojcën 1].

[Qyteti, data]	[Qyteti, data]
Për Këshillin e Europës	Për [emri i Huamarrësit]
Banka për Zhvillim	

SHTOJCA 3A
MODEL I NOTËS PREMTUESE PËR NJË PËRQINDJE INTERESI FIKSE
F/P 1515 - [nr.] kështu

NOTË PREMTUESE

[MONEDHA]	[SHUMA]	[DATA]
PËR SHUMËN E AKORDUAR, nënshkruesi:		

Me anë të kësaj Note Premtuese, zotohet t'i paguajnë Bankës për Zhvillim të Këshillit të Europës apo ndonjë institucioni tjetër, principalin prej:

[SHUMA në fjalë] [MONEDHA në fjalë],

në këstet në datat e specifikuara si më poshtë vijon, si dhe me interesat e specifikuar si më poshtë.

Në datat e specifikuara më poshtë, duhet të kryhen pagesat për një shumë të përgjithshme siç parashikohet në vijim, duke përfshirë këtu edhe rimbursimet lidhur me principalin dhe interesat për diferencën e papaguar të principalit.

[DATA]

PRINCIPALI:

		[MONEDHA] [SHUMA]
	---	---
	---	---
[DATA]		INTERESI:
		[MONEDHA][SHUMA]
	---	---
	---	---

Pagesat e mësipërme duhen kryer në:
 [NUMRIN E LLOGARISË DHE BANKËN KORRESPONDUESE TË CEB-it],
 në përfitim të Bankës për Zhvillim të Këshillit të Europës, pa zbritje të ose mbi llogari të
 ndonjë prej taksave, tatimeve a detyrimeve të tjera të tanishme ose të ardhshme të imponuara ose të
 marra kundër kësaj note ose përfitimeve të saj nga ose brenda shtetit nënshkrues, ose ndonjë organizmi
 politik a tatimvënës të tij.

Kjo Letër Pranimit përbën një rrjedhojë me një kredi të dhënë nga Banka për Zhvillim e
 Këshillit të Europës, Huamarrësit me

Më datë [DATA E DISBURSIMIT].

Në rast mospagese të shpejtë dhe të plotë të shumave të detyruara sipas kësaj Note Premtuese,
 tërë principi dhe interesi në datën e pagesës do të bëhen të detyruara dhe do të paguheshin sipas
 zgjedhjes dhe me kërkesën e mbajtësit të saj.

Moszbatimi nga ana e mbajtësit të saj i të drejtave të mësipërme nuk përbën ndonjë përjashtim
 nga të drejtat e tij në këtë instancë ose ndonjë tjetër.

Për HUAMARRËSIN

SHTOJCA 3 B
 MODELI I NOTËS PREMTUESE PËR PËRQINDJEN E INTERESIT TË LUHATSHËM
 F/P 1515 - [nr] këstit

NOTË PREMTUESE

[MONEDHA] [SHUMA] [DATA]
 PËR SHUMËN E AKORDUAR, nënshkruesi:
 Me anë të kësaj Note Premtuese, zotohet t'i paguajnë Bankës për Zhvillim të Këshillit të
 Europës apo ndonjë institucioni tjetër, principalin prej:
 [SHUMA në fjalë] [MONEDHA në fjalë],
 në këstet në datat e specifikuara si më poshtë vijon, si dhe me interesat e specifikuar si më
 poshtë.

[DATA]		PRINCIPALI:
		[MONEDHA] [SHUMA]
	---	---
	---	---
[DATA]		INTERESI:
		[MONEDHA][SHUMA]
	---	---
	---	---
	---	---

Pagesat e mësipërme duhen kryer në:

[NUMRIN E LLOGARISË DHE BANKËN KORRESPONDUESE TË CEB-it],
në përfitim të Bankës për Zhvillim të Këshillit të Europës, pa zbritje të ose mbi llogari të ndonjë prej taksave, tatimeve a detyrimeve të tjera të tanishme ose të ardhshme të imponuara ose të marra kundër kësaj note ose përfitimeve të saj nga ose brenda shtetit nënshkrues ose ndonjë organizmi politik a tatimvënës të tij.

Kjo Letër Pranimi përbën një rrjedhojë me një kredi të dhënë nga Banka për Zhvillim e Këshillit të Europës, Huamarrësit me

Më datë [DATA E DISBURSIMIT].

Në rast mospagese të shpejtë dhe të plotë të shumave të detyruara sipas kesaj Note premtuese, tërë principali dhe interesi në datën e pagesës do të bëhen të detyruara dhe do të paguhën sipas zgjedhjes dhe me kërkesën e mbajtësit të saj.

Moszbatimi nga ana e mbajtësit të saj i të drejtave të mësipërme nuk përbën ndonjë përjashtim nga të drejtat e tij në këtë instancë ose ndonjë tjetër.

Për HUAMARRËSIN

SHTOJCA 4
TABELA E LIMITEVE

Kategoria	Vlera e Kontratës (EUR 000)	Metoda e Prokurimit
Punime	Mbi 5 000	ICB (Tender i hapur ndërkombëtar)
	Ndërmjet 750 dhe 5000	NCB (Tender i hapur lokal)
	Ndërmjet 250 dhe 750	NCB (Tender i hapur lokal) i thjeshtuar
	Nën 250	Tre kuotime
Konsulenca	Mbi 150 për firma	QCBS (Përzgjedhje Bazuar në Cilësi dhe Kosto)
	Nën 150 për firma	QBS (Përzgjedhje bazuar në cilësi)
	Mbi 50 për individë	LCS (Përzgjedhje sipas koston më të ulët)
	Nën 50 për individë	Përzgjedhje bazuar në kualifikimet

SHTOJCA 4 a

KOSTOT

Date:

'ENDI: SHQIPERI

'PROJEKTI: FIP 1515 (2005) - Faza e Pare e Projektit te Qendres Spitalore Universitare "Nene Tereza" Tirane

VSH E EKSKLUDUAR

ARTIKULLI I BUXHETIT TE PUNIMEVE	VLERESUAR NE APROVIM	SHPENZIMET E KRVERA				SHPENZIMET E ARDHSHME				KOSTO TOTALE E = C+D	% E SHPENZI MEVE F = C/E	MODIFIKIME DHE KOMENTE
		Shpenzuar perpara aprovimit	2005 as of ...	SHPENZUAR NE TOTAL C = A+B	2005 as of ...	2005 as of ...	2006	2007	2008	TOTAL I SHPENZIMEVE TE ARDHSHME D		
'unime Ndertimi	ALL											
	USD 20.250.000	0										
Master Plani	ALL											
	USD 900.000	900.000										
'AISJET	ALL											
	USD 4.000.000	4.000.000										
Supervizion	ALL											
	USD 900.000	0										
Auditim	ALL											
	USD 150.000	0										
Kosto Administrative per PIU)	ALL											
	USD 100.000	0										
TOTAL I SHPENZIMEVE	ALL											
	USD 26.300.000	4.900.000										
lesalaria e Kursit te Kombimit ALL/USD												
perdorur per periudhen e specifikuar												

Ju lutem modifikoni titullin e kolonave conform progjesit te shpenzimeve vjelore".

TABELA 1

Date:

RVSH E EKSKLUDUAR

[illegible]

Shkurtimet qe përdoren :
 CB = Tender i Hapur Nderkombetar
 IB = Tender i Kulizuar Nderkombetar
 ICB = Tender i Hapur Lokal
 J = Kuolim
 KC= Kontraktim Direkt

BOR= Fondet e Veta te Huamarresit

KREDIA E DHENE NGA CEB

Date:

KREDIA E AUTORIZUAR: USD 14.000.000

VENDI: SHQIPERI

PROJEKTI: FIP 1515 (2005) - Faza e Pare e Projektit te Qendres Spitalore Universitare "Nene Tereza" Tirane
TVSH E EKSKLUDUAR

[illegible]

Sektion per perdomin e brendshem nga CEB

Sektion geodetischer Perfituesi

TABELA 3

SHTOJCA 4 d

BURIMET E FINANCIMIT

Shperndarja e Fondeve

NE USD 000

Date:.....

VENDI: SHQIPERI

PROJEKTI: F/P 1515 (2005) - Faza e Pare e Projektit te Qendres Spitalore Universitare "Nene Tereza" Tirane

TVSH E EKSKLUDUAR

ARTIKULLI I BUXHETIT TE PUNIMEVE	2004	2005	2006	2007	2008	TOTAL	MODIFIKIME
CEB	0						
Qeveria Shqiptare	0						
Banka BOTERORE	4.900						
TOTAL	4.900						

TABELA 4

SHTOJCA 4 e

SKEDULI I PUNIMEVE

Date:

SKEDULI DHE PROGRESI I PUNIMEVE
DIAGRAMVENDI: SHQIPERI
PROJEKTI: F/P 1515 (2005)

Faza e Pare e Projektit te Qendres Spitalore Universitare "Nene Tereza" Tirane

ARTIKULLI I BUXHETIT TE PUNIMEVE	Skeduli i Punimeve	2004												2005												2006												2007												2008												% OF PHYSICAL WORK COMPLETED	MODIFIKIME DHE KOMENTE																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																									
		1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																							
Godina A	Original																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																							

TABELA 4

OBJEKTIVAT

ENDI: SHQIPERI

ROJEKTI: P/P 1515 (2005) - Faza e Pare e Projektit te Qendres Spitalore Universitare "Nene Tereza" Tirane

PERSHKRIMI I PUNIMEVE TE PARASHIKUARA TE INFRASTRUKTURES	POPULLATA PERFITUESE NE ZONEN E SPITALIT	NUMRI I PACIENTEVE HYRES NE VIT			NUMRI I PACIENTEVE DALES NE VIT			NUMRI I SHITRETERVE						% E QARKULLIMIT TE SHTRATIT NE VIT			SIPERFAQJA BRUTO E KATEVE NE M2			MODIFIKIME DHE KOMENTE
		Pepara	Pas	Aktualisht	Pepara	Pas	Aktualisht	Pepara	Pas	Aktualisht	Pas	Aktualisht	Pas	Pepara	Pas	Aktualisht	Pepara	Pas	% Redol	
- Vlerimi i nje godine te re dhe etabilimit i tre godineve te tjera ne karakteristikat e njezoshme; - Godina A (ndertimi I ri godine) - Godina H1 (rehabilitim) - Godina K1 (rehabilitim) - Godina B1 (rehabilitim) Rrugel lidhese Parking per 196 hapesira makinash Lulshire, gardino, plika kontrolli	3 700 000	50 000	56 000					119	90								0	13 700		

* Ne daten e Raportit Prognoze

TABLE 6

LIGJ
Nr.9413, datë 20.5.2005

**PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS TË KROACISË PËR
SHËRBIMET AJRORE**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës të Kroacisë për shërbimet ajrore”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.4619, datë 6.6.2005 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

MARRËVESHJE
**NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS
TË KROACISË NË LIDHJE ME SHËRBIMET AJRORE**

Qeveria e Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës së Kroacisë (të quajtura më poshtë “Palët Kontraktuese”,

duke qenë palë të Konventës së Aviacionit Civil Ndërkombëtar e hapur për nënshkrim në Çikago më 7 dhjetor 1944,

duke dashur të përfundojnë një marrëveshje shtesë ndaj Konventës së mësipërme për qëllim të vendosjes së shërbimeve ajrore ndërmjet territoreve të tyre përkatëse, kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1
Përkufizime

Për qëllim të kësaj Marrëveshjeje, dhe në qoftë se konteksti nuk e përmban ndryshe:

a) Termi “Konventa e Çikagos” nënkupton Konventën mbi Aviacionin Civil Ndërkombëtar hapur për nënshkrim në Çikago më 7 dhjetor 1944 dhe përfshin: (i) çdo amendament që ka hyrë në fuqi sipas nenit 94 (a) dhe ratifikuar nga të dyja Palët Kontraktuese; dhe (ii) çdo aneks ose amendament i pranuar sipas nenit 90 të kësaj Konvente, për aq kohë sa ky amendament apo aneks është efektiv për të dyja Palët Kontraktuese.

b) Termi “autoritete aeronautike” nënkupton, në rastin e Republikës së Shqipërisë, Ministrinë e Industrisë, Transportit dhe Tregtisë – Drejtorinë e Përgjithshme të Aviacionit Civil dhe në rastin e Republikës së Kroacisë, Ministrinë e Çështjeve Detare, Transportit dhe Komunikacionit, dhe për

qëllim të nenit 7, Autoriteti i Aviacionit Civil ose në të dyja rastet, çdo person ose organ, i cili duhet të jetë i autorizuar të kryejë çdo funksion aktualisht të ushtrueshëm me autoritetet e lartpërmendura ose funksione të ngjashme;

c) termi “linjë ajrore e emëruar” nënkupton një linjë ajrore, e cila është emëruar dhe autorizuar në përputhje me nenin 4 të kësaj Marrëveshjeje;

d) termi “territor” në lidhje me një shtet ka kuptimin e përcaktuar në nenin 2 të Konventës së Çikagos;

e) termi “shërbime ajrore”, “shërbim ajror ndërkombëtar”, “linjë ajrore” dhe “qëndrim për qëllime jo trafiku” kanë kuptimet e caktuara respektivisht në nenin 96 të Konventës së Çikagos;

f) termi “kjo marrëveshje” përfshin aneksin dhe çdo amendament të tij ose të kësaj Marrëveshjeje;

g) termi “detyrime të qëndrimit” nënkupton detyrimin e aplikuar ndaj linjës ajrore nga organet kompetente ose lejimin nga ana e tyre të përdorimit të aeroportit ose pajisjeve të tij apo të pajisjeve të lundrimit ajror duke përfshirë dhe shërbimet e pajisjet që lidhen me avionët, ekuipazhet e tyre, udhëtarët dhe mallrat.

Neni 2

Zbatueshmëria e Konventës së Çikagos

Dispozitat e kësaj Marrëveshjeje kushtëzohen nga dispozitat e Konventës së Çikagos, për aq kohë sa ato dispozita janë të zbatueshme për shërbimet ajrore ndërkombëtare.

Neni 3

Dhënia e të drejtave

1) Çdo Palë Kontraktuese i jep Palës tjetër Kontraktuese të drejtat e mëposhtme përsa i përket shërbimeve ajrore ndërkombëtare:

a) të drejtën për të fluturuar përmes territorit të saj pa ulje;

b) të drejtën për të bërë ndalesa në territorin e saj për qëllime jo trafiku.

2) Çdo Palë Kontraktuese i jep Palës tjetër Kontraktuese të drejtat e specifikuara sa më poshtë në këtë Marrëveshje për qëllime të operimit të shërbimeve ajrore ndërkombëtare në rrugët e specifikuara në seksionet e planifikimit që i është shtuar kësaj Marrëveshjeje. Këto shërbime dhe rrugë janë quajtur më poshtë respektivisht “shërbime të miratuara” dhe “rrugë të caktuara”.

Gjatë operimit në një shërbim të miratuar në rrugë të caktuar, linjat ajrore të miratuara, nga secila Palë Kontraktuese duhet të gëzojnë, përveç të drejtave të përcaktuara në paragrafin (1) të këtij neni, edhe të drejtën për të bërë ndalesa në territorin e Palës tjetër Kontraktuese në pikat e caktuara për atë rrugë në shtojcën e kësaj Marrëveshjeje, me qëllim për të marrë ose lënë udhëtarët, dhe mallra duke përfshirë dhe postën.

3) Paragrafi (2) i këtij neni nuk nënkupton dhënien e së drejtës ndaj linjave ajrore të emëruara të Palës tjetër Kontraktuese për të marrë në bord, në territorin e Palës tjetër Kontraktuese, udhëtarë, mallra duke përfshirë postën, me qira ose pagesë, për t'i transportuar në një pikë tjetër të Palës tjetër Kontraktuese.

4) Në qoftë se për shkak të konflikteve të armatosura, ngjarjeve apo trazirave politike, ose rrethanave të veçanta dhe të pazakonta, linja ajrore e emëruar e njëres Palë Kontraktuese nuk është në gjendje të kryejë shërbimet në rrugën e saj të zakonshme, Pala tjetër Kontraktuese do të bëjë përpjekje maksimale për të lehtësuar vazhdimin e operimit të shërbimeve të tilla nëpërmjet riorganizimit të përkohshëm të rrugëve.

Neni 4

Miratimi dhe autorizimi i linjave ajrore

1) Çdo Palë Kontraktuese ka të drejtën t'i caktojë me shkrim Palës tjetër Kontraktuese një ose

më shumë linja ajrore, me qëllim për të operuar në shërbimet e miratuara në rrugët e caktuara dhe t'i tërheqë ose ndryshojë ato.

2) Me marrjen e këtij miratimi, Pala tjetër Kontraktuese duhet, sipas dispozitave të paragrafëve (3) dhe (4) të këtij neni, t'i japë pa vonesë linjës ajrore ose linjave ajrore të miratuara autorizimet e nevojshme operuese.

3) Autoritetet aeronautike të njërës Palë Kontraktuese mund t'i kërkojnë linjës ajrore të emëruar nga Pala tjetër Kontraktuese që do t'i bindë ata se është e kualifikuar për të plotësuar kushtet që rrjedhin nga ligjet dhe rregullat që aplikohen normalisht për operimin e shërbimeve ajrore ndërkombëtare nga këto autoritete në përputhje me dispozitat e Konventës së Çikagos.

4) Çdo Palë Kontraktuese ka të drejtën të refuzojë dhënien e automimeve operuese, të cilësuara në paragrafin (2) të këtij neni, ose t'u imponojë kushte të tilla të dala të nevojshme gjatë ushtrimit të të drejtave të specifikuara në nenin 3 (2) të kësaj Marrëveshjeje, në qoftë se Pala Kontraktuese e lartpërmendur nuk bindet se pronësia e konsiderueshme dhe kontrolli efektiv i kësaj linje i takon Palës Kontraktuese që miraton linjën apo në kombësinë e saj.

5) Kur linja ajrore është e miratuar dhe e autorizuar apo mund të fillojë të operojë ato shërbime të miratuara, me kusht që linja të zbatojë dispozitat e zbatueshme të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 5

Revokimi ose pezullimi i autorizimeve operuese

1) Çdo Palë Kontraktuese ka të drejtën të revokojë një autorizim operues ose të pezullojë ushtrimin e të drejtave të specifikuara në nenin 3 (2) të kësaj Marrëveshjeje nga një linjë ajrore e emëruar nga Pala tjetër Kontraktuese ose të vendosë kushte të tilla që mund t'i quajë të nevojshme gjatë ushtrimit të atyre të drejtave:

a) në çdo rast kur nuk bindet se pronësia bazë dhe kontrolli teknik i kësaj linje ajrore janë dhënë nga Pala tjetër Kontraktuese që përcakton linjën ajrore ose nga shtetasit e secilës Palë Kontraktuese;

b) kur linja ajrore nuk është në gjendje të veprojë në përputhje me ligjet dhe rregullat që zbatohen normalisht dhe në mënyrë të arsyeshme nga Pala Kontraktuese që i jep këto të drejta;

c) në qoftë se linja ajrore nuk operon në përputhje me kushtet e përshkruara në këtë Marrëveshje.

2) Në qoftë se deri sa revokimi imediat, pezullimi apo imponimi i kushteve të përmendura në paragrafin (1) të këtij neni nuk janë esenciale për të parandaluar shkeljet e mëtejshme të ligjeve dhe rregullave, atëherë këto të drejta duhet të ushtrohen vetëm pas konsultimeve me Palën tjetër Kontraktuese.

Neni 6

Parimet që rregullojnë operimin e shërbimeve të miratuara

1) Duhet të ekzistojnë mundësi të barabarta dhe të njëjta që linjat ajrore të emëruara të të dyja Palëve Kontraktuese të kryejnë shërbimet në rrugët e caktuara ndërmjet territoreve të tyre respektive.

2) Gjatë operimit të linjave ajrore të miratuara, çdo Palë Kontraktuese duhet të ketë parasysh interesat e linjave ajrore të Palës tjetër Kontraktuese, në mënyrë që të mos ndikojë negativisht në shërbimet që kryen ky i fundit në të gjithë rrugën apo pjesë të saj.

3) Shërbimet e miratuara që kryhen nga linjat ajrore të Palëve Kontraktuese duhet të plotësojnë kërkesat e publikut për transport në rrugët e caktuara dhe duhen të kenë si detyrë të parë sigurimin e një kapaciteti të përshtatshëm për momentin dhe për perspektivën për plotësimin e kërkesave për transportin e udhëtarëve, ngarkesave, duke përfshirë dhe postën, që vijnë ose kanë për destinacion territorin e Palës tjetër Kontraktuese që ka miratuar linjën ajrore. Sigurimi i transportit të mallrave dhe udhëtarëve, postës që merren në bord dhe shkarkohen në pikat e territoreve të shteteve të tjera nga ato që kanë miratuar linjën ajrore, duhet të kryhet në bazë të parimeve të përgjithshme që

kapaciteti duhet të lidhet me:

- a) kërkesat e trafikut për në dhe nga territori i Palës Kontraktuese që ka miratuar linjën;
- b) kërkesat e trafikut të zonës nëpërmjet së cilës kalon shërbimi i miratuar, mbas marrjes në konsideratë të shërbimeve të tjera të transportit të vendosura nga linjat ajrore të shteteve që përbëjnë zonën;
- c) kërkesat e operimit nëpërmjet linjës ajrore.

Neni 7 Tarifat

1)(a)Termi “tarifë” nënkupton:

- i) çmimin që vihet për transportin e udhëtarëve, bagazheve, mallrave (përfshirë dhe postën);
 - ii) mallrat shtesë, shërbimet apo përfitimet e tjera që sigurohen ose bëhen të vlefshme në lidhje me këtë transport ose ndonjë problem që del si incident dhe pasojat prej tij;
 - iii) çmimet që vihen për të tilla mallra shtesë, shërbimet ose përfitimet;
- dhe përfshihen kushtet që i vënë në zbatim këto çmime, si dhe sigurimin e këtyre mallrave, shërbimeve ose përfitimeve;

iv) përqindjen e komisionit që i paguan linja ajrore një agjenti për biletat e shitura ose faturat ajrore të plotësuara nga ai agjent për transportin në shërbimin ajror të planifikuar.

b) Kur biletat apo përqindjet ndryshojnë sipas stinës, ditës së javës apo dhe orës kur kryhet një fluturim, drejtimi i udhëtimit sipas disa faktorëve të tjerë çdo ndryshim i biletës apo pagesës duhet të konsiderohet se një tarifë e veçantë, pavarësisht nëse është planifikuar ndryshe apo jo sipas kushteve të autoriteteve të duhura.

2) Tarifat që vë linja ajrore e miratuar për transportin ndërmjet dy Palëve Kontraktuese duhet të caktohen në nivele të arsyeshme duke pasur parasysh gjithë faktorët, duke përfshirë interesat e përdoruesve, koston e operimit, fitimin dhe konsideratën e tregut.

3) Autoritetet aeronautike të të dyja Palëve Kontraktuese nuk duhet t’u kërkojnë linjave të tyre ajrore që të konsultohen me linjat e tjera ajrore përpara se të paraqesin për aprovim tarifat për shërbimet e mbuluara nga dispozitat e mëposhtme.

4) Autoritetet aeronautike të të dyja Palëve Kontraktuese duhet të aplikojnë dispozitat e mëposhtme për aprovimin e tarifave të secilës Palë Kontraktuese për transportin ndërmjet një pike në territorin e një Pale Kontraktuese dhe një pike në territorin e Palës tjetër Kontraktuese.

a) Çdo tarifë e propozuar për transportin ndërmjet territoreve të të dyja Palëve Kontraktuese duhet të paraqitet me shkrim nga linja ajrore e emëruar, në të dy autoritetet aeronautike jo më vonë se 30 ditë (ose për një kohë që dy autoritetet aeronautike kanë rënë dakord) para kohës së propozuar që tarifa do të hyjë në fuqi.

b) Një tarifë e tillë mund të aprovohet në çdo kohë nga autoritetet aeronautike. Megjithatë sipas dy nënparagrafëve të mëposhtëm, çdo tarifë e tillë duhet të trajtohet si e aprovuar si 21 ditë mbas marrjes së propozimit, në qoftë se autoritetet aeronautike të të dyja Palëve Kontraktuese nuk kanë informuar njëra-tjetrën me shkrim brenda 20 ditëve nga marrja e propozimit që ato nuk aprovojnë tarifën e propozuar.

c) Paragrafi i mësipërm (b) nuk nënkupton që autoritetet aeronautike të secilës Palë Kontraktuese të mos refuzojë në mënyrë të njëanshme çdo tarifë të propozuar nga ndonjë linjë e tyre ajrore. Megjithatë, ky veprim i njëanshëm duhet të ndërmerret vetëm në qoftë se këtyre autoriteteve u rezulton që, ose tarifa e propozuar është shumë e lartë, ose përdorimi i saj do të përbëjë një masë jo konkurruese, e cila do t’i shkaktonte pasoja serioze linjës ajrore ose linjave ajrore të tjera.

d) Në qoftë se autoritetet aeronautike të çdo Pale Kontraktuese gjykojnë gjithashtu se një tarifë e vendosur prej tyre në një linjë ajrore të miratuar të Palës tjetër Kontraktuese është e skajshme ose se

zbatimi i saj mund të krijojë një qëndrim jokompetitiv, që mund të shkaktojë pasoja serioze për linjën apo linjat e tjera ajrore, ato brenda 20 ditëve nga marrja e propozimit mund të kërkojnë konsultime me autoritetet aeronautike të Palës tjetër Kontraktuese. Këto konsultime duhet të bëhen brenda 20 ditëve nga paraqitja e kërkesës dhe tarifa hyn në fuqi në fund të kësaj periudhe, po qe se autoritetet e të dyja Palëve Kontraktuese nuk kanë rënë dakord ndryshe.

e) Por mbi nënparagrafët (a)–(d) autoritetet aeronautike të të dyja Palëve Kontraktuese nuk do të kërkojnë paraqitjen për tarifat e tyre të aprovuara për transportin e mallrave ndërmjet pikave në territoret e tyre. Këto tarifa kanë efekt kur linja ajrore ka interes të vendosë kështu.

f) Në rastin kur një tarifë, që ka hyrë në fuqi sipas dispozitave të mësipërme, konsiderohet nga autoritetet aeronautike të një Pale Kontraktuese si një shkak serioz që dëmton një linjë tjetër ajrore ose linja ajrore në një rrugë të veçantë ose rrugë, këto autoritete aeronautike mund të kërkojnë konsultime me autoritetet aeronautike të Palës tjetër Kontraktuese. Konsultime të tilla duhet të përfundojnë brenda 21 ditëve nga marrja e kërkesës, në qoftë se autoritetet aeronautike të të dyja Palëve Kontraktuese nuk bien dakord ndryshe.

5) (a) Tarifat që vë linja ajrore e emëruar e një Pale Kontraktuese për transportin ndërmjet territorit të Palës tjetër Kontraktuese dhe një vendi të tretë, paraqiten për aprovim tek autoritetet aeronautike të Palës tjetër Kontraktuese. Çdo tarifë e vendosur, në qoftë se është e njëjtë në nivel, në kushte dhe datë mbarimi me një tarifë të sapo miratuar nga ato autoritete aeronautike dhe që përdoret nga një linjë ajrore e miratuar e asaj Pale Kontraktuese për transport nëpërmjet territorit të tij dhe të një shteti të tretë, me kusht që këto autoritete aeronautike mund të anulojnë miratimin në qoftë se tarifa ndërpritet për ndonjë arsye, ose mund të ndryshojë kushtet e miratimit për të korresponduar me ndonjë ndryshim të miratuar në tarifën e vënë.

b) Megjithatë mbi paragrafin (a) autoritetet aeronautike të të dyja Palëve Kontraktuese nuk do kërkojnë miratimin e tarifave të tyre të aprovuara të vëna nga linjat ajrore të miratuara të një Pale Kontraktuese për transportin e mallrave nëpërmjet territorit të Palës tjetër Kontraktuese dhe të një vendi të tretë.

Neni 8

Taksat doganore

1) Avioni i linjës ajrore të emëruar ose i linjave ajrore të emëruara të secilës Palë Kontraktuese, që kryejnë shërbime ajrore ndërkombëtare lehtësohen nga taksat doganore, akcizat dhe taksa të tjera të ngjashme si:

a) Artikujve të mëposhtëm të futur nga një linjë ajrore e një Pale Kontraktuese në territorin e Palës tjetër Kontraktuese:

- i) pajisje riparimi, mirëmbajtje, shërbimi dhe pjesët përbërëse;
- ii) pajisjet e shërbimit për udhëtarë dhe pjesët përbërëse;
- iii) pajisjet e ngarkimit të mallrave dhe pjesët përbërëse;
- iv) pajisjet e sigurimit përfshirë komponentët përbërës që u bashkohen atyre;
- v) materialet mësimore dhe mjetet e kualifikimit;
- vi) dokumentet e linjës ajrore dhe operatorët.

b) Artikujt të futur nga linja ajrore e miratuar e një Pale Kontraktuese në territorin e Palës tjetër Kontraktuese ose artikujt që i jepen linjës ajrore të miratuar të njërës Palë Kontraktuese në territorin e Palës tjetër Kontraktuese:

i) furnizimet e avionit (që përfshijnë, por nuk kufizohen me artikuj ushqimorë, pajisje, cigare) që futen ose merren në bord në territorin e Palës tjetër Kontraktuese;

- ii) karburant, lubrifikante dhe pajisje teknike konsumi;
- iii) pjesë këmbimi përfshirë motora;

me kusht që këto të jenë për përdorim në bordin e avionit ose brenda kufijve të një aeroporti ndërkombëtar përsa i përket mirëmbajtjes së kryer nga linja ajrore në një shërbim ajror ndërkombëtar.

2) Përfshirja nga taksat doganore dhe taksat e tjera shtetërore nuk duhet të përfshijë pagesat bazuar në koston e shërbimeve që u bëhen shoqërive ajrore të miratuara të një Pale tjetër Kontraktuese

në territorin e Palës tjetër Kontraktuese.

3) Pajisjet dhe mjetet referuar paragrafit (1) të këtij neni mund të kërkohen të mbahen nën mbikëqyrjen apo kontrollin e autoriteteve kompetente.

4) Përfshirje nga taksat e këtij neni duhet të jenë të vlefshme në situata ku linja ajrore e miratuar ose linjat ajrore të një Pale Kontraktuese të kenë hyrë në marrëveshje me linja të tjera ajrore për huazimin ose transferimin në territorin e Palës tjetër Kontraktuese të artikujve të përcaktuar në paragrafin (1) të këtij neni, me kusht që këto linja të tjera ajrore të gëzojnë të njëjtat përjashtime për taksat nga kjo Palë tjetër Kontraktuese.

5) Udhëtarët, bagazhi dhe mallrat në transitin direkt përmes territorit të secilës Palë Kontraktuese.

Neni 9

Sigurimi në avion

1) Garantimi i sigurisë për avionët civilë, udhëtarët dhe ekuipazhin përbën një parakusht themelor për operimin e shërbimeve ajrore ndërkombëtare, Palët Kontraktuese riafirmojnë detyrimet e tyre për njëra-tjetrën për sigurimin e avionit civil ndaj akteve të ndërhyrjes së paligjshme (dhe në veçanti detyrimet e tyre sipas Konventës së Çikagos, Konventës mbi kundërvajtjet dhe aktet e tjera të kryera në bordin e avionit, nënshkruar në Tokio më 14 shtator 1963, Konventës për neutralizimin e rrëmbimit të paligjshëm të avionit, nënshkruar në Hagë më 16 dhjetor 1970, Konventës për neutralizimin e akteve të paligjshme kundër sigurisë së aviacionit civil, nënshkruar në Montreal më 23 shtator 1971, si dhe amendamentin e protokollit për ndalimin e akteve të paligjshme të forcës në aeroporte, nënshkruar në Montreal më 24 shkurt 1988) formojnë një pjesë integrale të kësaj Marrëveshjeje.

2) Palëve Kontraktuese sapa t'u jepet njoftimi, duhet të sigurojnë ndihmën e nevojshme për njëra-tjetrën për të parandaluar aktet e rrëmbimit të paligjshëm të avionëve, kundër sigurisë së këtyre avionëve, udhëtarëve dhe ekuipazheve, aeroporteve dhe mjeteve të navigimit dhe çdo kërcënimi tjetër të sigurisë së aviacionit civil.

3) Palët Kontraktuese në marrëdhëniet e tyre reciproke, duhet të veprojnë në përputhje me standardet e sigurimit në aviacion dhe për aq sa ato i zbatojnë, me praktikën e rekomanduar nga Organizata e Aviacionit Civil Ndërkombëtar dhe të përcaktuara si anekse në Konventën e Çikagos; dhe duhet të kërkojnë që operatorët e avionëve të regjistrimit të tyre, operatorët të cilët e kanë vendin kryesor të punës apo rezidencën të përhershme në territoret e tyre, si dhe operatorët e aeroporteve në territoret e tyre, të veprojnë në përputhje me këto dispozita të sigurimit në aviacion. Në këtë paragraf referenca për standardet e sigurimit në aviacion përfshin edhe ndryshimet e bëra nga Palët Kontraktuese të interesuara. Çdo Palë Kontraktuese duhet t'i japë informacionin paraprak Palës tjetër Kontraktuese për ndryshimet që ka ndërmend të bëjë.

4) Çdo Palë Kontraktuese duhet të kujdeset që të marrë masa efektive brenda territorit të saj për ruajtjen e avionëve, kontrollin e udhëtarëve dhe të bagazheve, si dhe të kryejë kontroll mbi ekuipazhet, mallrat (që përfshijnë dhe bagazhin e dorës) dhe bagazhin e avionit para dhe gjatë bordingut apo ngarkimit, gjithashtu duhet të bëhet kujdes që këto masa të përshtaten sipas rritjes apo uljes së rrezikut. Çdo Palë Kontraktuese bie dakord që linjave të saj ajrore mund t'u kërkohet të vëzhgojnë dispozitat e sigurisë në aviacion sipas paragrafit (3) të kërkuara nga Pala tjetër Kontraktuese për hyrjen, largimin ose kur ndodhen brenda në territorin e Palës tjetër Kontraktuese.

Çdo Palë Kontraktuese duhet t'i përgjigjet çdo kërkesë të Palës Kontraktuese për marrjen e masave të veçanta të sigurisë për të përballuar një rrezik të caktuar.

5) Kur ndodh një incident ose kur ka rrezik të ndodhë një incident, si p.sh. rrëmbim i paligjshëm avioni ose akte të tjera të paligjshme kundër udhëtarëve, ekuipazheve, aeroporteve etj., duhet lehtësuar komunikimi dhe duhen marrë masa të tjera për të neutralizuar këto incidente sa më shpejt dhe me një rrezik sa më minimal për jetën.

Neni 10

Mbajtja e statistikës

Autoritetet aeronautike të një Pale Kontraktuese duhet t'u sigurojnë autoriteteve aeronautike të Palës tjetër Kontraktuese, me kërkesën e tyre, statistika periodike ose të tjera për qëllime të studimit të kapaciteteve të linjave ajrore të Palës tjetër Kontraktuese që përmenden në fillim në këtë nen. Këto statistika duhet të përfshijnë edhe të dhëna që kërkohen për të përcaktuar globalin e trafikut të kryer nga këto linja ajrore, si dhe origjinën dhe destinacionin e këtij trafiku.

Neni 11

Transferimi i fitimeve

Çdo linjë ajrore e emëruar ka të drejtë të konvertojë dhe të transferojë në vendin e vet të ardhurat lokale që përbëjnë mbi shumat e paguara në atë vend ku kryen aktivitetin.

Konvertimi dhe transferimi duhet të lejohet pa kufizime sipas raportit të shkëmbimit që aplikohet për transaksionet koherente, raport i cili vepron në kohën që këto të ardhura paraqiten për konvertim dhe transferim. Këto të ardhura normalisht i paguhen bankës për kryerjen e këtyre operacioneve.

Neni 12

Përfaqësuesit e linjave ajrore dhe shitje

1) Linja ajrore e miratuar ose linjat e një Pale Kontraktuese kanë të drejtë, në bazë të ligjeve dhe rregullave të Shtetit Kontraktues përsa i përket hyrjes, qëndrimit e punësimit, të sjellin dhe mbajnë në territorin e Palës tjetër Kontraktuese personelin e tyre drejtues, teknik dhe operacional të nevojshëm për kryerjen e shërbimeve ajrore.

2) Linjat ajrore të miratuara të çdo Pale Kontraktuese kanë të drejtë të angazhohen në shitjet në transportin ajror në zonën e Palës tjetër Kontraktuese në mënyrë direkte ose nëpërmjet agentëve të emëruar nga këto linja ajrore. Këto linja ajrore kanë të drejtë të shesin, dhe çdo person duhet të jetë i lirë t'i blejë këto shërbime (bileta etj.) në monedhën lokale ose në ndonjë valutë të konvertueshme.

Neni 13

Taksat e përdoruesit

1) Pala Kontraktuese nuk duhet t'i imponojë ose të lejojë që shoqërive ajrore të Palës tjetër Kontraktuese t'i imponohen taksa përdoruesi më të larta se ato që i caktohen shoqërive të saj ajrore që kryejnë shërbime ajrore ndërkombëtare të ngjashme.

2) Çdo Palë Kontraktuese duhet të inkurajojë konsultimet mbi taksat e përdoruesit ndërmjet autoriteteve të saj taksëvënëse dhe shoqërive ajrore që përdorin mjetet ndihmëse dhe përfitojnë shërbimet që i sigurojnë këto autoritete taksëvënëse (ndonjëherë nëpërmjet organeve përfaqësuese të këtyre shoqërive ajrore).

Për çdo propozim për ndryshime të këtyre taksave duhet t'u jepet njoftim paraprak këtyre përdoruesve, për t'i lejuar ata të shprehin mendimet e tyre para se të bëhen ndryshimet.

Çdo Palë Kontraktuese duhet të inkurajojë më tej autoritetet e saj taksëvënëse dhe përdoruesit që të shkëmbejnë informacion, përsa u përket taksave të përdoruesve.

Neni 14 **Konsultimet**

Secila Palë Kontraktuese në çdo kohë, mund të kryejë konsultime mbi zbatimin, interpretimin apo ndryshimin e kësaj Marrëveshjeje, si dhe për rënien dakord për këtë Marrëveshje. Këto konsultime, të cilat bëhen prej autoriteteve aeronautike, duhet të zhvillojnë brenda 60 ditëve nga data që Pala tjetër Kontraktuese merr kërkesën me shkrim, në qoftë se nuk bien dakord ndryshe nga Palët Kontraktuese.

Neni 15 **Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

1) Në qoftë se ndërmjet Palëve Kontraktuese del ndonjë mosmarrëveshje lidhur me interpretimin apo zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, Palët Kontraktuese pikë së pari duhet të përpiqen t'i zgjidhin ato me bisedime.

2) Në qoftë se Palët Kontraktuese nuk arrijnë një zgjidhje të mosmarrëveshjes me bisedime, ajo mund t'i referohet një personi apo organi për të cilin bien dakord me kërkesën e secilës Palë Kontraktuese, dhe duhet t'i nënshtrohet për veprim një gjyqi prej 3 gjykatësish, të cilët caktohen në këtë mënyrë:

a) Brenda 30 ditëve nga marrja e kërkesës për arbitrazh, çdo Palë Kontraktuese duhet të caktojë një gjyqtar si president i gjyqit do të veprojë një qytetar i një shteti të tretë, i cili do të caktohet si gjyqtar i tretë me marrëveshje ndërmjet dy gjyqtarëve, brenda 60 ditëve nga caktimi i gjyqtarit të dytë.

b) Në qoftë se brenda kufijve kohorë të caktuar si më sipër nuk është bërë ndonjë emërim, çdo Palë Kontraktuese mund t'i kërkojë presidentit të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë të bëjë emërimet e nevojshme brenda 30 ditëve.

Në qoftë se presidenti është me të njëjtën kombësi me një nga Palët Kontraktuese, atëherë nënpresidenti më i vjetër, i cili të jetë i kualifikuar në këtë fushë, të bëjë emërimet.

3) Pavarësisht nga dispozitat e këtij neni apo si mund të bihet dakord nga Palët Kontraktuese, gjyqtari duhet të përcaktojë kufijtë e juridiksionit të tij dhe të vendosë procedurën e tij.

Nën drejtimin e gjyqtarëve ose me kërkesën e secilës Palë Kontraktuese duhet të bëhet një mbledhje për të përcaktuar pikat konkrete që do të gjykohen, si dhe procedurat specifike që do të ndiqen. Kjo mbledhje duhet mbajtur jo më vonë se 30 ditë pasi është kompletuar plotësisht gjykata.

4) Çdo Palë Kontraktuese duhet të paraqesë një memorandum brenda 45 ditëve pasi është kompletuar gjykata, në qoftë se nuk bihet dakord ndryshe nga Palët Kontraktuese apo nga gjykata.

Përgjigjet jepen pas 60 ditësh. Gjykata duhet që me kërkesën e secilës Palë Kontraktuese ose me iniciativën e saj, të dërgojë pretendimet e Palëve brenda 60 ditëve pasi janë dhënë përgjigjet.

5) Gjykata duhet të japë një vendim me shkrim; brenda 30 ditëve pas dëgjimit, në qoftë se nuk ka pasur dëgjim pretendimesh, 30 ditë pasi janë dhënë të dyja përgjigjet.

Vendimi merret me shumicë votash.

6) Palët Kontraktuese mund të bëjnë kërkesë për sqarim të vendimit brenda 30 ditëve pas marrjes. Ky sqarim duhet të bëhet brenda 15 ditëve nga kërkesa.

7) Vendimi i Gjykatës është i detyruar për Palët Kontraktuese.

8) Çdo Palë Kontraktuese paguan koston e gjyqtarit të zgjedhur nga ajo. Çdo kosto tjetër duhet të ndahet në mënyrë të barabartë nga Palët Kontraktuese ku përfshihen shpenzimet e bëra nga presidenti apo nënpresidenti i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë në zbatimin e procedurave të paragrafit (2) (b) të këtij neni.

Neni 16 **Ndryshimet**

1) Çdo ndryshim i kësaj Marrëveshjeje që bihet dakord nga të dyja Palët, hyrja në fuqi do të

bëhet pas konfirmimeve me anë të shkëmbimeve të notave.

2) Secila Palë Kontraktuese mund të kërkojë konsultime në përputhje me nenin 14, mbi amendamentet në këtë Marrëveshje, e cila mund të jetë përshtatur nga hyrja në fuqi e konventave shumëpalëshe lidhur nga të dyja Palët Kontraktuese.

Neni 17

Prishja e Marrëveshjes

Secila Palë Kontraktuese në çdo kohë mund t'i japë njoftim me shkrim Palës tjetër Kontraktuese për ta vënë në dijeni për prishjen e Marrëveshjes. Ky njoftim duhet t'i komunikohet në të njëjtën kohë dhe Organizatës së Aviacionit Civil Ndërkombëtar. Kjo Marrëveshje do të përfundojë në mesnatë (në vendin e marrjes së njoftimit) menjëherë para përvjetorit të parë të datës së marrjes së njoftimit nga Pala tjetër Kontraktuese, në qoftë se njoftimi nuk tërhiqet me shkrim përpara përfundimit të kësaj periudhe. Në mungesë të konfirmimit të marrjes së njoftimit nga Pala tjetër Kontraktuese, njoftimi do të konsiderohet si i marrë 14 ditë pas marrjes së njoftimit nga Organizara e Aviacionit Civil Ndërkombëtar.

Neni 18

Hyrja në fuqi

Kjo Marrëveshje hyn në fuqi mbas kryerjes së kërkesave nga çdo Palë Kontraktuese, në datën e njoftimit të fundit në të cilin çdo Palë Kontraktuese ka vënë në dijeni me shkrim tjetrën dhe do të jetë në zbatim përkohësisht nga data e nënshkrimit.

Besimi për firmosjen e kësaj Marrëveshjeje është reciprokisht e autorizuar nga qeveritë respektive të tyre.

Bërë në Zagreb, datë 2 gusht 1995 në dy kopje origjinale, në gjuhët shqip, kroatisht dhe anglisht.

Në rast problemi në interpretim, mbizotëron teksti anglisht.

ANEKS

Plani i rrugëve

PJESA I-RË

Rrugët që do të operohen nga linja ajrore e emëruar ose linjat ajrore të Republikës së Shqipërisë.

Pikat në Republikën e Shqipërisë – Pikat ndërmjetëse – Pikat në Republikën e Kroacisë – Pikat e përtejme.

Shënim.

1. Pikat e ndërmjetme ose pikat e përtejme duhet të jenë përjashtuar nga çdo fluturim siguruar që shërbimi fillon ose mbaron në Republikën e Shqipërisë.

2. Asnjë fluturim nuk duhet të kryhet nga një pikë e ndërmjetme për t'u ulur në territorin e Republikës së Shqipërisë ose në territorin e Republikës së Kroacisë për t'u ulur në një pikë të përtejme dhe anasjelltas, përveç se me aprovimin e herëpashershëm nga autoritetet aeronautike të Palëve Kontraktuese. Ky kufizim gjithashtu është i vlefshëm për të gjitha format e fluturimit me ndalesë.

PJESA II-TË

Prurët që do të operohen nga linja ajrore e emëruar ose linjat e Republikës së Shqipërisë.
Pikat në Republikën e Kroacisë – Pikat e ndërmjetme – Pikat në Republikën e Shqipërisë –
Pikat e përtejme.

Shënim.

1. Pikat e ndërmjetme ose pikat e përtejme duhet të jenë përjashtuar nga çdo fluturim siguruar që shërbimi fillon ose mbaron në Republikën e Kroacisë.

2. Asnjë fluturim nuk duhet të kryhet nga një pikë e ndërmjetme për t'u ulur në territorin e Republikës së Shqipërisë ose në territorin e Republikës së Kroacisë për t'u ulur në një pikë të ndërmjetme dhe anasjelltas, përveçse në aprovimin e herëpashershëm nga autoritetet aeronautike të Palëve Kontraktuese, ky kufizim gjithashtu është i vlefshëm për të gjitha format e fluturimit me ndalesë.

Fletorja Zyrtare gjendet:

Duke u abonuar për çdo vit pranë:

- çdo njësie postare të qyteteve;
- Qendrës së Publikimeve Zyrtare:
Bulevardi Zhan d'Ark, pranë ish-ekspozitës "Shqipëria Sot".
Tel: 042 555 63; 267 468

Për çdo lloj informacioni, shihni faqen e internetit në adresën:

www.legjislacionishqiptar.gov.al

Pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare mund të gjeni:

BOTIMET:

1. KUSHTETUTA (edhe anglisht)
2. KODI I PROCEDURËS CIVILE
3. KODI I PROCEDURËS PENALE
4. KODI PENAL
5. KODI I PUNËS
6. KODI I FAMILJES
7. KODI CIVIL
8. KODI RRUGOR DHE LIGJI PËR TRANSPORTIN
9. KODI ZGJEDHOR (i azhurnuar)
10. KODI I PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE
11. DISPOZITA ZBATUESE TË KODIT RRUGOR

PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI:

1. PËRMBLEDHJE E LEGJISLACIONIT NË FUSHËN E PËRMBARIMIT
2. PËRMBLEDHJE E LEGJISLACIONIT NË FUSHËN E PROKURIMIT PUBLIK
3. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR NËPUNËSIN CIVIL
4. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR SISTEMIN E DREJTËSISË
5. PËRMBLEDHJE NË FUSHËN E TAKSAVE DHE TATIMEVE

DOLI NGA SHTYPI:

TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT SHQIPTAR 1990-KORRIK 2004

TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT SHQIPTAR 1990-KORRIK 2004

Doli nga shtypi më 23.6.2005

Tirazhi: 4300 copë	Formati: 60x88/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2005

Çmimi 150 lekë